

# INDEKSI

KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE

2018

 KCSF

FONDAZIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE  
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

## **AUTOR DHE UDHËHEQËS I HULUMTIMIT**

Dren Puka

## **HULUMTUES**

Nart Orana

## **NDIHMËS HULUMTUESE**

Mirjeta Ademi

## **RECENSUES**

Taulant Hoxha

Ky publikim është përkrahur financiarisht nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), nëpërmjet projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP). KCSF mbështetet nga Sida. Përmbajtja e këtij publikimi është në tërësi përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdomërisht qëndrimet e SCO-K apo Sida-s.

Të drejtat e rezervuara © 2018. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Fotografia e Ballinës: Arben Llapashtica

Dhjetor 2018

# Përmbajtja

Hyrje.....	5
Metodologjia .....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Struktura e shoqërisë civile në Kosovë.....	10
<b>Korniza ligjore.....</b>	<b>14</b>
Liria e asociimit.....	14
Liritë e tjera.....	15
Raportimi financiar .....	16
Auditimet financiare .....	17
<b>Qeverisja dhe kapacitetet e brendshme.....</b>	<b>18</b>
Organet udhëheqëse .....	18
Vendimmarrja.....	19
Dokumentet e brendshme dhe transparenca .....	21
Të punësuarit.....	22
Rekrutimi i të punësuarve.....	23
Kapacitetet e brendshme.....	24
Rrjetëzimi dhe komunikimi .....	26
<b>Angazhimi i qytetarëve.....</b>	<b>27</b>
Aktivizmi qytetar.....	27
Vullnetarizmi.....	29
<b>Financimi .....</b>	<b>32</b>
Qarkullimi vjetor.....	32
Burimet e financimit .....	35
Kohëzgjatja e financimit dhe planifikimi i punës .....	36
Llojet e përkrahjes.....	37
Programimi i fondeve të donatorëve .....	40
Fondet e BE-së.....	41
Fondet publike .....	42
Kontratat shtetërore për shërbime publike.....	45
Përkrahja jofinanciare.....	45
<b>Ndikimi i perceptuar .....</b>	<b>46</b>
Reagueshmëria .....	46
Ndikimi i perceptuar .....	48
Avokimi.....	49
Qasja në informata.....	51
Pjesëmarrja në politikëbërje.....	52
<b>Ambienti i jashtëm .....</b>	<b>56</b>
Konteksti socio-ekonomik .....	56
Konteksti socio-politik .....	58
Konteksti socio-kulturor .....	60

(Figura 1: OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri Publik i OJQ-ve)  
(Figura 2: Format e regjistrimit të OJQ-së – Burimi: Regjistri publik i DOJQ)  
(Figura 3: Trendi i regjistrimit të OJQ-ve sipas viteve (1999-2017) – Burimi: Regjistri i DOJQ)  
(Figura 4, OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri Publik i OJQ-ve dhe ATK)  
(Figura 5, Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 6, OJQ-të sipas numrit të angazhuarve gjatë vitit 2017 – Burimi: ATK)  
(Figura 7, Format e presionit nga shteti apo ndërhyrjes në punët e brendshme të organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 8, Pjesëmarrja e OShC-ve në tubime publike dhe organizimi i tubimeve publike nga ana e OShC-ve gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 9, Përvojat e OShC-ve në kufizimin e lirisë së shprehjes së tyre – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 10, OShC-të me +10,000 EURO të hyra dhe që kanë deklaruar së paku 1 punëtor/e)  
(Figura 11, OJQ-të me së paku një auditim të jashtëm financiar sipas qarkullimit vjetor për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 12, Organet më të larta drejtuese të deklaruara nga shoqatat – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 13: Shpeshësia e takimeve të organeve më të larta drejtuese – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 14, Organi i cili merr vendimet kryesore të organizatës – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 15: Ekzistimi e dokumenteve të brendshme – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 16: Shpërndarja gjeografike e të punësuarve të OJQ-ve – Burimi: FKPK)  
(Figura 17: Shpërndarja gjinore e të punësuarve në shoqëri civile dhe në sektorë të tjerë në vitin 2015 – Burimi: FKPK)  
Figura 18, Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 19, Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë krahasuar me qarkullimin vjetor të OShC-ve për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
Figura 20: Vetëvlerësimi i kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 21: Rrjetëzimi i OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 22. Frekuenca e takimeve të OShC-ve me anëtarët e rrjetit/rrjeteve – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 23, Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete publike – Burimi: Puls i Publik i UNDP-së)  
(Figura 24, Angazhimi i qytetarëve dhe mendimi i tyre për shoqëri civile në vitet 2013, 2015 dhe 2017 – Burimi: Puls i publik XIV i UNDP-së)  
(Figura 25: Perceptimet e OShC-ve për trendët e vullnetarizmit në shoqëri civile gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 26, Angazhimi i qytetarëve në punë vullnetare – Burimi: Puls i publik XIV i UNDP-së)  
(Figura 27, Angazhimi i vullnetarëve nga OShC-të – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 28: Numri i vullnetarëve krahasuar me numrin e punëtorëve me paga në OShC-të e anketuara, gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 29, Forma e angazhimit të vullnetarëve në OShC – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 30, Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 31, Numri i projekteve në zbatim të OShC-ve për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 32, Trendi i të hyrave të OShC-ve në vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 33, Numri i OShC-ve që kanë arritur të sigurojnë mjaftueshëm fonde për të siguruar vazhdimësinë e punës së organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 34, Burimet e financimit të sektorit të shoqërisë civile për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 35: OShC-të sipas burimeve të financimit – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 36, Kohëzgjatja e planifikimit të punës së OShC-ve për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 37, Raporti ndërmjet kohëzgjatjes së projekteve dhe planifikimit të punës së organizatës – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 38, Lloji i përkrahjes së dhënë OShC-ve nga donatorët e huaj gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me donator)  
(Figura 39, Lloji i procedurave të aplikimit për fondet e huaja gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 40, Vlerësimi i donatorëve lidhur me procedurat e aplikimit për fonde të huaja gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me donator)  
(Figura 41, Llojet e OShC-ve të cilat ftohen nga donatorët e huaj për programimin e fondeve të tyre – Burimi: Anketa me donator)  
(Figura 42, Aplikimi i OShC-ve për fonde të BE-së gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 43, Lloji i procedurave të aplikimit për fondet publike gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 44, Shuma e kontratave për fonde publike – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 45, Kontratat për fonde publike në bazë të nivelit qeverisës – Burimi: Anketa me OShC dhe Raporti i Qeverisë për vitin 2017)  
(Figura 46, Aplikimi për kontrata shtetërore përmes prokurimit publik gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 47, Llojet dhe sfidat e përkrahjes jofinanciare të OShC-ve gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 48: Perceptimi i OJQ-ve për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore të qytetarëve – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 49: Perceptimi i palëve të jashtme për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore për qytetarët – Burimi: Anketa me Perceptimeve të Jashtme)  
(Figura 50: Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të shoqërisë civile në përgjithësi – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 51, Komunikimi i OShC-ve me institucionet publike të cilat veprojnë në fushën e njëjtë me atë të organizatës së tyre – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 52, Komunikimi i OShC-ve me institucionet publike përgjegjëse për bashkëpunim me shoqëri civile – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 53: Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqëri civile – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 54, Informimi i OShC-ve nga institucionet publike për punën e tyre në fushën e veprimit të organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 55, Përvoja e OShC-ve gjatë procesit të konsultimit publik – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 56, Pranimi i shpjegimit në rast të refuzimit të komenteve të OShC-ve gjatë procesit të konsultimit – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 57, Pranimi i komenteve të OShC-ve gjatë procesit të konsultimit publik – Burimi: Anketa me OShC)  
(Figura 58: Trendët e mendimeve të qytetarëve për drejtimin politik, proceset demokratike dhe gatishmërinë për protesta – Burimi: Puls i publik XIV i UNDP-së)  
(Figura 59: Niveli i besimit të qytetarëve në shoqëri civile – Burimi: Puls i Publik XIV i UNDP-së)  
(Figura 60. Niveli i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve – Burimi: Puls i Publik XIV i UNDP-së)

# Hyrje

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile (IKShC) është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) që vlerëson gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë në baza periodike. Ky studim e vazhdon traditën e KCSF-së në ofrimin e informatave gjithëpërfshirëse mbi sektorin e shoqërisë civile në Kosovë, e filluar me Antologjinë e shoqërisë civile më 2001, Analizën e shoqërisë civile në Kosovë më 2005, Indeksën e Shoqërisë Civile për Kosovë të CIVICUS më 2011, Indeksën Kosovar të Shoqërisë Civile më 2014, dhe Indeksën Kosovar të Shoqërisë Civile më 2016, dhe edicionin aktual, Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2018. Ky studim ndërmerret çdo dy vite dhe i mat dimensionet kryesore të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Metodologjia e studimit bazohet në botimet e kaluara të Indeksit të Shoqërisë Civile 2011, 2014, dhe 2016, por ka përshtatje të metodave hulumtuese për të adresuar krakteristikat e veçanta të shoqërisë civile në Kosovë. Metodologjia përfshin hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, anketa parësore, dhe analizën e të dhënave.

Anketat janë ndërmarrë në fund të vitit 2017 dhe fillim të vitit 2018, dhe kanë mbledhur informata për vitin kalendarik 2017. IKShC i mbulon shtatë fusha kryesore që e karakterizojnë punën e sektorit të shoqërisë civile: struktura e sektorit, korniza ligjore, qeverisja dhe kapacitetet e brendshme, angazhimi qytetar, financimi, ndikimi i perceptuar dhe ambienti i jashtëm për veprimtari të shoqërisë civile.

Duke paraqitur shpjegime të detajuara të një numri të madh të indikatorëve, ky raport u dedikohet për përdorim ekspertëve, hulumtuesve dhe profesionistëve, si dhe vendim-marrësve në institucionet publike, organizatat donatore dhe OShC-ve të cilat merren me sektorin e shoqërisë civile. Për të pasur një shtrirje më të gjerë të audiencat jashtë grupeve të përmendura më lart, rezultatet e IKShC 2018 janë paraqitur edhe në platforma shtesë, përfshirë vizualizimin e mbi 50 variablave kryesore.

## Metodologjia

Metodologjia e hulumtimit e Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile 2018 (IKShC) është bazuar në një numër metodash që janë përdorur për komponentë të ndryshëm të raportit, duke përfshirë hulumtimin e literaturës dhe rishikimin e kornizës ligjore, grumbullimin e të dhënave parësore përmes anketave, si dhe analizat statistikore të të dhënave relevante të grumbulluara nga institucionet e tjera.

Hapi i parë, ai i grumbullimit të të dhënave parësore ka përfshirë anketën me organizata të shoqërisë civile (Anketa me OShC) me pjesëmarrje të 101 organizatave nga mbarë Kosova, e cila është bërë përmes intervistave sy me sy gjatë muajve nëntor 2017 – shkurt 2018. Me qëllim të kontrollit të ndërthurtë të aspekteve të rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë civile, siç janë, qeverisja e brendshme e organizatave, kapacitetet lidhur me aplikimin për fonde dhe për zbatimin e programeve e projekteve të tyre, burimet e financimit dhe të ngjashme, është realizuar anketa me donatorët më të rëndësishëm për shoqërinë civile në Kosovë. Informatat për perceptimet e jashtme lidhur me rolin dhe ndikimin e shoqërisë civile janë mbledhur përmes anketës me 101 aktorë të jashtëm me interes apo hisedarë nga fusha të ndryshme relevante për sektorin e shoqërisë civile, duke përfshirë: institucionet e ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor; institucionet publike (ofruesit publikë të shërbimeve shëndetësore, shkollat fillore, institucionet publike të kulturës), ndërmarrjet publike, agjencitë e pavarura, komunat, sektorin privat, mediet, botën akademike, përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Kosovë, dhe partnerët ndërkombëtarë zhvillimorë. Të dhënat përkritazi me perceptimet e qytetarëve për shoqërinë civile, për praktikën e tyre të vullnetarizmit dhe për aktivizmin në sektorin e shoqërisë civile janë marrë nga anketa e UNDP-së për Pulsin Publik XIV, e cila ka intervistuar një mostër përfaqësuese prej 1306 respondentëve nga tërë Kosova.

Rishikimi i kornizës ligjore është bazuar në Matricën e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile. Matrica monitoron në baza vjetore një vistër të standardeve dhe indikatorëve, në legjislacion dhe praktikë, të të gjitha elementeve që e përbëjnë ambientin për veprimtari të shoqërisë civile. KCSF ndërmerr këtë monitorim që nga viti 2013.

Mostra e Anketës me OShC është përzgjedhur nga Regjistri i OJQ-ve i Departamentit për OJQ në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, e cila kishte gjithsej 9,015 organizata vendore dhe 530 të huaja dhe ndërkombëtare. Me qëllim të mbledhjes së informatave gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese për sektorin në aspektin e madhësisë, fushës së aktivitetit, viteve të punës në sektor dhe shpërndarjes gjeografike, është përdorur metodologjia e mostrimit të rëndomtë shtresor. Mostra e anketës është përzgjedhur në bazë të dy hapave:

1) Caktimit të targeteve për kategoritë e shtresave: 10 OShC të mëdha dhe të konsoliduara, 5 OShC ndërkombëtare, 5 OShC nga komuniteti serb dhe 5 OShC nga komunitetet e tjera etnike (joshqiptare dhe joserbe). Për të siguruar përfaqësim gjeografik të organizatave, pjesëmarrësit në anketë janë ndarë në rajone, dhe atë si në vijim: më së paku 15 OShC nga Prishtina dhe më së paku 10 OShC nga rajonet e tjera kryesore të Kosovës. Përveç kësaj, në çdo nënmostër rajonale, është mostruar së paku një OJQ nga komunat më të vogla apo nga viset rurale. OShC-të nga komuniteti serb janë mostruar në komunat kryesisht të banuara me popullatë serbe: Mitrovicë të veriut, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë dhe Shtërpçë;

2) Përzgjedhja e rëndomtë e OShC-ve nga secila shtresë apo kategori, bazuar në listën e OJQ-ve të regjistruara. Për shkak të nivelit të lartë të OJQ-ve jo-aktive e që janë pjesë e Regjistrimit të OJQ-ve, metodologjia e njejtë e mostrimit është përsëritur disa herë, derisa është plotësuar numri përfundimtar i planifikuar i anketës.

Mostrimi i ngjashëm është përdorur edhe për Anketën e Perceptimeve të Jashtme, me të vetmin dallim në listën fillestare të mostrës. Për shkak që nuk ka ndonjë regjistrim zyrtar të hisedarëve të jashtëm, ekipi hulumtues fillimisht ka përpiluar një listë të kategorive bashkë me numrat e përafërt të respondentëve për secilën shtresë. Një numër i hisedarëve të jashtëm janë propozuar për secilën shtresë, nga ekipi hulumtues dhe pjesa tjetër e stafit të KCSF-së, përbërje e mostrës kjo e cila është identike me atë të edicionit të kaluar të IKShC. Këta individë janë përzgjedhur bazuar në tre kritere të veçanta: 1) ata të cilët janë më bashkëpunues me shoqërinë civile; 2) ata të cilët janë më aktivë dhe të zëshëm në fushat e tyre të veprimtarisë; 3) ata të cilët janë më së paku të ekspozuar ndaj shoqërisë civile. Të intervistuarit në anketë kanë qenë nga sektorë të ndryshëm, siç është Kuvendi i Kosovës (6), Qeveria e Kosovës (11), Komunitat (15), Gjyqësori (3), Sektori privat (6), Mediet (10), Akademia (8), Partitë politike (6), Policia e Kosovës (2), Agjencitë e pavarura (4), Institucionet tjera publike (12), Organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare (3), Organizata të huaja donatore (5), Misioni ndërkombëtar në Kosovë (2), Misione diplomatike në Kosovë (3), dhe Komunitetet fetare (5).

Anketa me OShC dhe Anketa e Perceptimeve të jashtme janë zbatuar nëpërmjet intervistave sy më sy, në zyret e respondentëve, ndërsa Anketa me Donatorë është zbatuar nëpërmjet një platforme online të anketimit. Shumica e pyetjeve në secilën anketë kanë qenë pyetje të mbyllura, edhe pse në raste të veçanta janë përfshirë edhe pyetje të hapura, kryesisht në ato raste kur ka qenë e vështirë të kategorizohen përgjigjet paraprakisht. Anketa me OShC përmbante 129 pyetje që kanë mbuluar tema si: demografia e përgjithshme; struktura organizative; menaxhimi, menaxhimi financiar, llogaridhënia, transparenca dhe lehtësirat fiskale; burime njerëzore (përfshirë vullnetarët) dhe kapacitetet e brendshme; rrjetëzimi dhe komunikimi brenda-sektoral; liria e asociimit dhe korniza ligjore për veprimtarinë e shoqërisë civile; liritë tjera themelore; infrastruktura përkrahëse; trendet dhe burimet e financimit; fondet publike dhe kontratat shtetërore; përkrahje jo-financiare nga shteti; ofrimi i shërbimeve; aktiviteti ekonomik, përfshirja e shoqërisë civile në programimin e fondeve të donatorëve të huaj; ndikimi i donatorëve në veprimtarinë e OShC-ve; avokimi, bashkëpunimi me institucionet publike, qasja në informata dhe konsultimi publik; perceptimi i ndikimit të shoqërisë civile; dhe ambienti i jashtëm për veprimtarinë e shoqërisë civile.

Anketa e Perceptimeve të Jashtme përmbante 10 pyetje që kanë mbuluar tema si: perceptimi i ndikimit të shoqërisë civile; aktiviteti i shoqërisë civile, besimi në shoqëri civile; financimi i shoqërisë civile; pjesëmarrja dhe ndikimi i shoqërisë civile në vendim-marrje; dhe ambienti i jashtëm për veprimtarinë e shoqërisë civile. Anketa me Donatorë përmbante 41 pyetje që kanë mbuluar tema si: programimi i fondeve të donatorëve për shoqëri civile dhe përfshirja e OShC-ve në programim; mekanizmat e përkrahjes për OShC dhe tipet e përkrahjes; kapacitetet e OShC-ve; efektiviteti i politikave zhvillimore për shoqëri civile; dhe ambienti i jashtëm për veprimtarinë e shoqërisë civile.

## Përmbledhje ekzekutive

Struktura e shoqërisë civile në Kosovë mbetet e ngjashme me atë të para dy viteve, me përjashtim të rritjes së vazhdueshme të numrit të OJQ-ve të regjistruara. Deri në dhjetor 2017, Regjistri i OJQ-ve ka numëruar 9,545 OJQ, ku mbi 95% janë të regjistruara si shoqata dhe pjesa tjetër fondacione. Rreth 1/3 e OJQ-ve të regjistruara janë nga komuna e Prishtinës, pasuar nga Prizreni dhe Mitrovica me një përqindje dukshëm më të vogël. OShC-të kanë përbërje gjinore të balancuar, për dallim nga sektorët tjerë në Kosovë ku gratë nuk e arrijnë as 1/3 e numrit të të punësuarve. Të dhënat nga studimi sugjerojnë se numri i OShC-ve aktive në Kosovë është rreth 1,000. Megjithatë, të dhënat zyrtare për organizata të shoqërisë civile vazhdojnë të mos jenë sistematike, duke përfshirë këtu edhe numrin e organizatave aktive dhe fushën e angazhimit apo karakteristikat tjera.

Korniza ligjore bazë për funksionimin e shoqërisë civile nuk ka pasur ndryshime. Edhe pse regjistrimi në autoritetet shtetërore nuk është parakusht për funksionim të një organizate të shoqërisë civile, shumica dërrmuese e tyre regjistrohen. Në përgjithësi, nuk janë vërtur kufizime të lirisë së asociimit, lirisë së tubimit, apo lirisë së shprehjes të anëtarëve të shoqërisë civile. Derisa OShC-të tregojnë nivel të lartë të zbatimit të kërkesave financiare dhe tatimore, Kosova vazhdon të mos ketë sistem të përshtatshëm për raportim financiar të OShC-ve, rrjedhimisht, OShC-të raportojnë në mënyrë të njejtë sikurse bizneset.

Kërkesat ligjore për qeverisje të brendshme të OShC-ve janë minimale, por megjithatë, ato zbatohen pak. Edhe pse obligim ligjor, më shumë së gjysma e shoqatave nuk e deklarojnë Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë vendimmarrës. Ngjashëm me edicionin e kaluar të Indeksit, sërish konfirmohet se posedimi i dokumenteve për rregullim të brendshëm të OShC-ve është i ndërlidhur me madhësinë dhe kapacitetet e organizatës. Rrjedhimisht, shumica dërrmuese e OShC-ve të mëdha dhe të konsoliduara posedojnë dokumente për rregullim të brendshëm.

Përkundër që një numër i madh i OShC-vë operojnë pa fonde, prapë se prapë, ky sektor punëson një numër të konsiderueshëm të stafit në radhët e veta. Të dhënat e këtij viti tregojnë një rritje të shumës totale të kontributeve të paguara nga të punësuarit në OShC, të cilët përbëjnë rreth 3.25% të kontribuesve në Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Në anën tjetër, shteti nuk ka dhe as nuk ka treguar interesim për politika të cilat do t'i trajtonin nevojat e veçanta të këtij sektori.

Angazhimi i qytetarëve në OShC mbetet i ulët, në përgjithësi. Megjithatë, krahasuar me vitet e kaluara vërehet një rritje e dukshme e numrit të qytetarëve që janë angazhuar në OShC, kanë bërë punë vullnetare për OShC, apo që kanë përfituar nga shërbimet që ofrohen nga OShC-të. Në anën tjetër, vërehet ka një rënie të lehtë të besimit të qytetarëve në shoqërinë civile dhe vlerësimin për punën që ky sektor bën. Megjithatë, shoqëria civile mbetet ndër sektorët më të besueshëm në Kosovë. Angazhimi vullnetar i qytetarëve në organizata të shoqërisë civile është rritur ndjeshëm krahasuar me dy vite më parë, gjë që konfirmon se shoqëria civile vazhdon të ketë më shumë vullnetarë se sa të punësuar.




Gati gjysma e OShC-ve në Kosovë operojnë pa fonde fare, dhe një numër shumë i madh i tyre operojnë me më pak se 10,000 EUR në vit. Vërehet një trend në rënie i financimit të OShC-ve në të gjithë indikatorët që masin këtë aspekt, përveç fondeve publike. Donatorët e huaj vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit për OShC në Kosovë, edhe pse me një rënie të dukshme krahasuar me të dhënat e vitit 2015. Në anën tjetër, është rritur financimi i OShC-ve nga fondet publike, si dhe numri i organizatave që kanë përfituar fonde nga institucionet publike. Edhe pse ka një rritje të përkrahjes institucionale për OShC, dominon përkrahja për projekte me afat të shkurtë dhe shuma të vogla, derisa shumë pak OShC përfitojnë përkrahje jo-financiare.

Demokratizimi vlerësohet si fusha ku shoqëria civile ka ndikim më së shumti, e pasuar nga sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, arsimit, dhe barazia gjinore. Njejtë sikurse në edicionet paraprake të Indeksit, akterët jashtë shoqërisë civile kanë mendim shumë më pozitiv për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e lartpërmendura. Përkundër që vërehet një përmirësim i qasjes në informata në institucione publike, në përgjithësi, OShC-të vlerësojnë se nuk janë mjaftueshëm të informuar nga institucionet publike për fushat në të cilat angazhohen. Në anën tjetër, edhe kur OShC-të kërkojnë qasje në dokumente publike, ato i marrin me vonesë. Krahasuar me vitin 2015, vërehet një rënie e madhe e numrit të organizatave që kanë marrë pjesë në ndonjë proces të politik-bërjes, apo që kanë pranuar ftesë për konsultim publik nga institucionet publike.

## Struktura e shoqërisë civile në Kosovë


Struktura e shoqërisë civile në Kosovë vazhdon të mbetet e ngjashme me atë të para dy viteve, me përjashtim të rritjes së vazhdueshme të numrit të OJQ-ve të regjistruara. Ngjashëm, mbesin prezente mungesa e të dhënave sistematike dhe të besueshme për numrin e OJQ-ve që ushtrojnë aktivitet në Kosovë. E kombinuar me natyrën e punës dhe organizimit të OJQ-ve në përgjithësi, kjo e pamundëson llogaritjen e saktë të numrit të organizatave aktive që veprojnë në vend.

Fillimisht, shoqëria civile përbëhet jo vetëm nga OJQ-të e regjistruara, por edhe nga llojet tjera të organizatave, të cilat mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa pasur nevojë të regjistrohen në autoritetet përkatëse shtetërore. Së dyti, edhe nëse fokusohemi vetëm tek organizatat e regjistruara, është e pamundur të llogaritet numri i saktë i organizatave që ushtrojnë aktivitet në Kosovë, dhe atë për dy arsye. Së pari, Departamenti për OJQ (DOJQ) nuk ka mekanizma për komunikim të rregullt me të gjitha OJQ-të. Së dyti, një OJQ konsiderohet aktive edhe nëse nuk ushtron aktivitet të përditshëm.




(Figura 1: OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri Publik i OJQ-ve)

Të regjistruara në Kosovë janë gjithsej 9,545 OJQ, prej të cilave, 9,015 janë OJQ vendore, dhe 530 OJQ të huaja ose ndërkombëtare. Nga këto, 1,493 janë klube sportive dhe federata të sportit, dhe 35 organizata fetare. Krahasuar me edicionet paraprake të Indeksit, kësaj radhe vërehet një numër shumë më i madh i kategorisë klube sportive apo shoqata të sportit, si dhe organizata fetare. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se gjatë dy viteve të fundit janë regjistruar shumë më shumë organizata nga kategoritë respektive, por që DOJQ ka punuar vazhdimisht në ri-kategorizim të organizatave ekzistuese. Më konkretisht, shoqëri për shoqërinë ka qenë një ndër kategoritë më problematike të Regjistrimit Publik të DOJQ, e cila ka numëruar më shumë se 3,000 organizata. Pas ri-kategorizimit, kjo kategori nuk figuron në Regjister Publik. Sa i përket formës së regjistrimit, 96% e OJQ-ve janë të regjistruara si shoqata, ndërsa 4% si fondacione, raport ky që mbetet i ngjashëm për shumë vite me radhë.



(Figura 2: Format e regjistrimit të OJQ-së – Burimi: Regjistri publik i DOJQ)


Vlen të theksohet se në këtë llogaritje nuk përfshihen OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare, pasi që Regjistri Publik i OJQ-ve nuk ka të dhëna rreth formës së regjistrimit të kësaj kategorie të OJQ-ve. Trendi i regjistrimit të OJQ-ve të reja është poashtu shumë i ngjashëm nga viti në vit. Përkundër që në periudhën 1999 – 2009 ka pasur lëvizje të theksuara të numrit të OJQ-ve të regjistruara, nga 2010 deri në 2016 mesatarja e OJQ-ve të reja të regjistruara është rreth 500 në vit.



(Figura 3: Trendi i regjistrimit të OJQ-ve sipas viteve (1999-2017) – Burimi: Regjistri i DOJQ)

Përkundër që Regjistri Publik i OJQ-ve numëron më shumë se 9,500 OJQ të regjistruara, ky numër nuk tregon gjendjen reale të sektorit apo numrin e organizatave aktive. Si rrjedhojë, për t'iu afruar një pasqyre më të qartë të numrit të organizatave aktive ose atyre që ushtrojnë ndonjë lloj aktiviteti gjatë një viti, duhet të konsiderohen të dhëna nga institucione tjera, si Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Në vitin 2009 ka filluar të zbatohet kërkesa për pajisje të OJQ-ve me Certifikatë të Numrit Fiskal, dokument ky i cili është parakusht për administrimin e çfarëdo lloj tatimi në Kosovë. Që nga ajo kohë deri me 31 dhjetor 2017, gjithsej 3,788 OJQ janë pajisur me numër fiskal. Prej tyre, gjatë vitit 2017, 973 OJQ kanë raportuar në ATK përmes deklaratimit të formularit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave (CD), 954 OJQ kanë paguar tatim apo kanë paraqitur qarkullim në deklaratimet e tyre vjetore, dhe 816 OJQ kanë deklaruar se kanë pasur staf të punësuar gjatë vitit 2017.




(Figura 4, OJQ-të në numra – Burimi: Regjistri Publik i OJQ-ve dhe ATK)

Nëse merret për bazë aktiviteti financiar i organizatës, siç janë të hyrat vjetore, punësimi i stafit, pagesa e tatimeve, Figura 4., tregon se numri i organizatave aktive në Kosovë është pak më pak se 1,000 OJQ. Në mënyrë indirekte, numri i përafërt prej 1,000 organizatave aktive konfirmohet nga hulumtimet të cilat realizohen me OJQ në Kosovë. Më konkretisht, gjatë zbatimit të anketave për këtë studim janë kontaktuar gjithsej 1,000 OJQ për ta plotësuar numrin e mostrës prej 101 anketave të realizuara. Prej tyre, rreth 90% (899 organizata) kanë deklaruar se organizata e tyre nuk ekziston apo është shuar. Derisa shuarja dhe çregjistrimi i një OJQ-je nuk ndërlidhet me aktivitetin ose jo të organizatës, një numër i madh i tyre, edhe pse kanë vendosur të shuhen një gjë të tillë nuk e raportojnë në DOJQ. Që nga viti 1999, numri i OJQ-ve që janë çregjistruar vullnetarisht pranë DOJQ-së është vetëm 122.


Sa i përket shtrirjes gjeografike të OJQ-ve, pjesa dërrmuese e tyre janë të përqendruara në zonat kryesore, urbane të Kosovës (69.55%). Prishtina është qyteti me më së shumti OJQ të regjistruara (36.8%), e ndjekur nga Prizreni (7.7%), Mitrovica (7.2%), Peja (5.79%), Gjilani (4.6%), dhe Gjakova (4.55%).

Anketa me OJQ tregon se rreth 55% e OJQ-ve operojnë me fonde dhe një numër i madh i tyre nuk kanë fare të hyra financiare (45.5%). Në mesin e OJQ-ve që kanë deklaruar të kenë të hyra vjetore, grupi më i madh bën pjesë në kategorinë më pak së 10,000 EUR të hyra në vit (22.8%), grupi i dytë më i madh është ai me të hyra prej 100,001 – 500,000 EUR në vit (6.9%). Ndërsa, vetëm 5.9% e OJQ-ve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.



(Figura 5. Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Në anën tjetër, nuk ka përmirësim në sistemin e të dhënave mbi të punësuarit në sektorin jo-qeveritar, ku vazhdojnë të mungojnë të dhënat për të punësuar me orar të plotë apo të pjesshëm, apo të dhëna tjera specifike për ta kuptuar këtë sektor si treg të punës. Të dhënat nga ATK tregojnë se numri total i OJQ-ve që kanë deklaruar të punësuar gjatë vitit 2017 është 816, dhe se këto 816 organizata kanë punësuar gjithsej 8,453 punëtorë<sup>1</sup>. Në anën tjetër, të dhënat e FKPK tregojnë që 3,533 kontribues nga OJQ kanë paguar kontribute pensionale pandërprerë përgjatë 12 muajve të vitit 2017. Më shumë se gjysma e tyre kanë deklaruar të kenë 1 deri 4 të punësuar (60%) dhe 1% e tyre kanë deklaruar më shumë se 100 të punësuar.



(Figura 6. OJQ-të sipas numrit të të angazhuarve gjatë vitit 2017 – Burimi: ATK)

<sup>1</sup> Të punësuar me orar të plotë dhe/ose të pjesshëm, përfshirë këtu edhe angazhimet me afat të shkurtë.


# Korniza Ligjore

## Liria e Asocimit

Në përgjithësi, gjatë dy viteve të fundit nuk ka pasur ndonjë ndryshim të theksuar në kornizën ligjore apo ushtrimin e lirisë së asocimit në Kosovë. Liria e asocimit është e drejtë kushtetuese, e garantuar përmes nenit 44 të Kushtetutës së Kosovës dhe e përcaktuar në Ligjin 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në OJQ. Kjo kornizë ligjore garanton të drejtën e çdo personi për ta ushtruar lirinë e asocimit pa pasur nevojë të regjistrojë organizatë.

Megjithatë, pjesa më e madhe e organizatave regjistrohen për të fituar statusin e subjektit juridik dhe përfitimet përcjellëse formale që vijnë nga të qenit subjekt juridik – siç është mundësia për hapjen e llogarisë bankare, aplikimi dhe pranimi i fondeve nga donatorët etj. Në Kosovë, OJQ-të mund të regjistrohen në dy forma, si shoqatë ose si fondacion. Shoqata është organizatë e bazuar në anëtarësi dhe mund të themelohet nga së paku tre persona, kurse fondacioni është organizatë e bazuar në kapital dhe mund të themelohet nga një person apo përmes testamentit.

Në kuadër të mostrës së anketës me OJQ, organizatat të cilat janë regjistruar në periudhën janar 2016 – dhjetor 2017 janë pyetur për përvojat e tyre gjatë procesit të regjistrimit. Nga gjithsej 11 organizata që janë përgjigjur në këtë pyetje, gjysma e tyre kanë deklaruar se procedura e regjistrimit ka qenë e lehtë dhe jo e kushtueshme. Megjithatë, ka pasur raste kur OJQ-të kanë raportuar probleme gjatë procedurës së regjistrimit, kryesisht të lidhura me mënyrën e marrjes së vendimeve nga DOJQ gjatë procesit të regjistrimit. Përderisa shumica dërrmuese e OJQ-ve nuk kanë raportuar ndonjë kufizim të ushtrimit të lirisë së asocimit gjatë vitit 2017, ka raste të izoluara të raportimit të kufizimeve të ndryshme. Një organizatë është ballafaquar me ngacmim të moderatorëve dhe/apo anëtarëve të grupeve online të organizatës, në një rast tjetër është raportuar për probleme me bankën për llogarinë bankare të organizatës, dhe një organizatë tjetër i'u është pamundësuar qasja në informim si rrjedhojë e mungesës të gjuhës së shenjave.



(Figura 7. Format e presionit nga shteti apo ndërhyrjes në punët e brendshme të organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Në katër raste, OJQ-të e anketuara janë ballafaquar me presion nga autoritetet shtetërore, apo ndërhyrje jo të ligjshme në punët e brendshme të organizatës. Nga këto katër raste, dy OJQ kanë deklaruar të kenë pasur ndërhyrje në punën e organizatës, një rast të kufizimit të paarsyeshëm të veprimtarisë së organizatës, dhe auditim të tepruar në një rast tjetër.


## Liritë tjera

Në përgjithësi, shoqëria civile në Kosovë vazhdon të mos ketë kufizime të shprehura të lirisë së tubimit, ndërsa gjatë dy viteve të fundit ka një rënie të nivelit, edhe ashtu të ulët të organizimit të tubimeve publike, nga organizatat e shoqërisë civile.

Liria e tubimit është e drejtë kushtetuese në bazë të nenit 43 të Kushtetutës, ndërsa në Ligjin 03/L-118 për tubimet publike të gjithë qytetarëve të Kosovës u garantohet e drejta që të organizojnë tubime publike dhe që të marrin pjesë në to. Njoftimi paraprak për tubimin publik është i obligueshëm, përveç në ato vende ku nuk kërkohen masa shtesë të sigurisë. Në rastet kur autoritetet nuk përgjigjen brenda kohës së paraparë (48 orë para tubimit publik), i njëjti mund të organizohet pa kufizime. Për çfarëdo kufizimi pas njoftimit për tubimin publik, organizatorët mund të ankohen në gjykatë përmes procedurës së përsheptuar.

Të dhënat e anketës tregojnë se rreth 15% e OJQ-ve kanë organizuar ndonjë lloj të tubimit publik (protestë, marsh, performancë në ambient të hapur) gjatë vitit 2017. Shumica dërrmuese e tyre nuk kanë hasur në ndonjë pengesë gjatë organizimit të tubimeve (75%), përderisa dy raste janë raportuar të kenë pasur kufizime të paarsyeshme nga autoritetet dhe për të cilat nuk kanë marrë ndonjë shpjegim, si dhe ballafaqim me procedura të tepërta administrative. Vetëm një rast është raportuar kur organizata ka hasur në pengesa nga autoritetet shtetërore për shkak të organizimit spontan të tubimit publik.


Ndërkaq, të pyetur nëse kanë marrë pjesë në tubime publike, qoftë përmes organizatës apo individualisht, 41% e respondentëve deklaruan se kanë marrë pjesë në tubime publike, dhe se në përgjithësi nuk kanë hasur në ndonjë kufizim. Në tre raste, OShC-të kanë deklaruar se gjatë pjesëmarrjes së tyre në tubime publike kanë hasur në kufizim të pjesëmarrjes së medieve në tubim, dhe vetëm një rast është raportuar si kufizim i tepërt i kohës së tubimit. Poashtu, 3% e OShC-ve deklaruan të kenë marrë pjesë në kundër tubime (tubime të grupeve kundërshtuese në vendin dhe kohën e njetë) gjatë vitit 2017, praktikë kjo e cila nuk ka qenë e shprehur në të kaluarën. Në përgjithësi, vërehet rënie e organizimit të tubimeve publike nga OShC-të krahasuar më të dhënat e vitit 2015, si dhe rënie e pjesëmarrjes në tubime publike.



(Figura 8. Pjesëmarrja e OShC-ve në tubime publike dhe organizimi i tubimeve publike nga ana e OShC-ve gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Kjo rënie vërehet edhe tek të dhënat e Policisë së Kosovës për numrin e përgjithshëm të tubimeve dhe protestave të organizuara në Kosovë gjatë vitit 2017. Derisa në vitin 2015 janë organizuar 344 protesta në gjithë Kosovën, në vitin 2017 kanë ndodhur vetëm 186 organizime të tilla.

Situatë e ngjashme është raportuar edhe në lirinë e shprehjes për organizatat dhe pjesëtarët e shoqërisë civile gjatë dy viteve të fundit. Në bazë të nenit 40 të Kushtetutës, liria e shprehjes është e garantuar për të gjithë, dhe mund të kufizohet vetëm nëse është e nevojshme për parandalimin e dhunës apo të urrejtjes racore, etnike a fetare. Të dhënat nga anketa me OJQ tregojnë se shoqëria civile në Kosovë në përgjithësi gëzon liri të shprehjes. Pjesa dërrmuese e OShC-ve deklaruan se nuk kanë pasur kufizime të paligjshme, siç është persekutimi për fjalime kritikuese (92%), kërcënimet për shkak se anëtarët e organizatës kishin mendime të kundërta (93%), ose bllokim të qasjes në mjete apo kanalet e komunikimit në internet (94%). Presioni si rezultat i kritikave ndaj autoriteteve shtetërore duket të jetë më problematik krahasuar me kufizimet tjera. Rreth 12% e OJQ-ve deklaruan të kenë pasur presion nga autoritetet shtetërore për shkak të kritikës ndaj tyre. Ndërkaq, të dhënat tregojnë se problemet për kufizim të kanaleve të komunikimit janë të pakta. Vetëm një rast është raportuar për monitorim të paligjshëm të komunikimit nga autoritetet shtetërore.




(Figura 9, Përvojat e OShC-ve në kufizimin e lirisë së shprehjes së tyre – Burimi: Anketa me OShC)

## Raportimi financiar

Ngjashëm me situatën e para dy viteve, OJQ-të në Kosovë ende vazhdojnë të mos kenë ndonjë sistem të përshtatshëm për raportim financiar, ndër të tjera duke pamundësuar informata të sakta mbi kategori të shumta financiare e tatimore të sektorit.

Numri i OJQ-ve të pajisura me numër fiskal ka vazhduar të rritet- nga 2,230 OJQ sa kanë qenë në fund të vitit 2015 në 3,788 në fund të vitit 2017. Poashtu, është rritur për 225 numri i OJQ-ve që kanë raportuar deklaratën vjetore CD në ATK. Duke supozuar që një organizatë me të hyra vjetore prej së paku 10,000 EUR ka aktivitet të rregullt gjatë pjesës dërrmuese të një viti fiskal dhe së paku një të punësuar, është analizuar nëse organizatat mbi këtë prag i zbatojnë kërkesat ligjore tatimore.





(Figura 10, OShC-të me +10,000 EURO të hyra dhe që kanë deklaruar së paku 1 punëtor/e - Burimi: Anketa me OShC)

Të dhënat nga anketa tregojnë se shumica dërrmuese e OJQ-ve të cilat kanë të hyra vjetore së paku 10,000 EUR në vit, dhe së paku një të punësuar, i paguajnë në baza të rregullta tatimin në të ardhura personale dhe kontributin pensional të stafit të tyre (92%). Në anën tjetër, vetëm 12% e OJQ-ve nga kjo kategori deklaruan se paguajnë sigurim shëndetësor për stafin e tyre, nivel ky që vazhdon të mbetet i ulët përgjatë viteve.


Përkundër që deklarata tatimore (CD) është obligative për të gjitha subjektet që posedojnë numër fiskal, dhe duhet të raportohet në ATK deri me 31 mars, vërehet se afër 3/4 e OJQ-ve dështojnë ta përmbushin këtë obligim ligjor. Pasiviteti i OJQ-ve gjatë një viti fiskal si rrjedhojë e mungesës së fondeve në njërin anë, dhe mungesa e informimit të mirëfilltë për obligimet tatimore në anën tjetër, janë vetëm disa nga arsyet që jo të gjitha OJQ-të e kryejnë këtë obligim vjetor.

Poashtu, të dhënat e anketës tregojnë se OJQ-të që marrin fonde prej donatorëve të huaj janë më të prirur për të deklaruar obligimet tatimore, në përgjithësi, për dallim prej OJQ-ve që marrin fonde nga institucionet publike të nivelit qendror ose lokal.

## Auditimet financiare

Auditimet financiare të OJQ-ve në Kosovë vazhdojnë të jenë prezente në shumicën e OJQ-ve që menaxhojnë shuma të konsiderueshme të mjeteve financiare, me rezultate edhe më pozitiv krahasuar me dy vitet e kaluara. OJQ-të me Status për Përfitim Publik (SPP) që kanë qarkullim vjetor mbi 100,000 EUR duhet të kenë auditim të jashtëm financiar. Rrjedhimisht, në rast kur një OJQ nuk ka SPP, pavarësisht të hyrave vjetore, ato nuk janë të obliguara që të ndërmarrin proces të auditimit financiar. Megjithatë, për shkak që është praktikë e mirë e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe kërkesë e shumicës së donatorëve, anketa me OJQ tregon se të gjitha organizatat me të hyra më shumë se 100,000 EUR në vit bëjnë auditime të rregullta financiare.

Poashtu, anketa me OShC tregon se rreth 18% e OJQ-ve kanë ndërmarrë së paku një auditim të jashtëm financiar gjatë vitit 2017. Pëkundër që në shikim të parë kjo përqindje duket të jetë e ulët, të dhënat e detajuara të anketës me OShC tregojnë se në mesin e organizatave që kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë auditim të jashtëm financiar, 46% prej tyre janë OJQ me zero të hyra vjetore, ndërsa të gjitha OJQ-të që kanë të hyra vjetore nga 100,000 EUR deri në 4 milion EUR kanë realizuar së paku një (1) auditim të jashtëm financiar. Madje, OJQ nga kjo kategori kanë raportuar të kenë ndërmarrë deri në katër (4) auditime të jashtme financiare gjatë vitit 2017.



(Figura 11, OJQ-të me së paku një auditim të jashtëm financiar sipas qarkullimit vjetor për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Nga Figura 11 vërehet se auditimet e jashtme financiare të OJQ-ve më të hyra vjetore mbi 100,000 EUR kanë mbetur thuajse të njëjta krahasuar me të dhënat e edicionit të kaluar të Indeksit. Derisa është rritur numri i organizatave me të hyra vjetore prej 25,000 EUR deri në 50,000 EUR që kanë realizuar së paku një auditim të jashtëm financiar, ka rënë numri i OJQ-ve me të hyra vjetore nën 25,000 EUR që kanë ndërmarrë një gjë të tillë.

## Qeverisja dhe kapacitetet e brendshme

### Organet udhëheqëse


Edhe pse me kërkesa minimale ligjore, një pjesë e konsiderueshme e OJQ-ve në Kosovë vazhdojnë të mos i zbatojnë si duhet ato, me një situatë të përkeqësuar gjatë dy viteve të fundit.

Bazuar në legjislacionin aktual në Kosovë, OJQ-të mund të regjistrohen në dy forma, si shoqata dhe si fondacione. Si organizata me anëtarësi që janë, nga shoqatat kërkohet të kenë Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë drejtues, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës. Organi më i lartë drejtues i fondacionit është Bordi i Drejtorëve, i emëruar nga themeluesi apo themeluesit e fondacionit, e pastaj i zgjedhur nga vet anëtarët e Bordit. Organi më i lartë drejtues ka një numër kompetencash të rezervuara, siç është miratimi i raporteve vjetore dhe planeve vjetore, ndryshimin e statutit dhe aktit themeltar, zgjedhjen e zyrtarëve më të lartë të OJQ-së, si dhe bashkimin, ndarjen apo shpërbërjen e OJQ-së. Kushtet tjera të përgjithshme për qeverisjen e brendshme ndërlidhen me konfliktin e interesit dhe ndalimin e angazhimit në fushata politike e zgjedhje.

Shumica dërrmuese e OJQ-ve janë të regjistruara si shoqata (96%), dhe vetëm një numër i vogël i tyre kanë zgjedhur të regjistrohen si fondacione (4%)<sup>2</sup>. Përkundër që regjistrimi i

<sup>2</sup>Kjo e dhënë nuk përfshin OJQ-të e huaja dhe ndërkombëtare, të cilat në Regjistrin Publik të OJQ-ve nuk kategorizohen në shoqata ose fondacione.

një OJQ-je është relativisht i lehtë, dhe ka kërkesa të qarta ligjore, respektimi i kërkesave ligjore bazë përtej momentit të regjistrimit mbetet sfidues. Më pak se gjysma e OJQ-ve të regjistruara si shoqata deklaruan se Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i organizatës (43%), derisa 41% e shoqatave deklaruan se Bordi i organizatës ka një funksion të tillë, dhe 16% e tyre thanë se drejtori apo drejtoresha. Rezultate të ngjashme, megjithatë pak më pozitive, janë konstatuar edhe në Indeksin për vitin 2015, ku 56.8% e shoqatave kishin deklaruar Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë drejtues.




(Figura 12, Organet më të larta drejtuese të deklaruara nga shoqatat – Burimi: Anketa me OShC)

## Vendimmarrja

Ngjashëm me vitet e kaluara, takimet e organeve më të larta drejtuese vazhdojnë të mbahen nga shumica e organizatave të paktën një herë në vit, edhe pse vetëm një pjesë e tyre marrin vendime të rëndësishme për organizatën.


Ligji për Liri të Asocimit në OJQ parasheh që organizatat e regjistruara në bazë të këtij ligji duhet ta mbledhin organin më të lartë drejtues së paku një herë në vit, ku i njehti organ do të duhej të miratojë raportet vjetore narrative dhe financiare të organizatës për vitin paraprak, si dhe aprovimin e planeve vjetor për vitin e ardhshëm. Të dhënat nga anketa tregojnë se OJQ-të, në masë të madhe, i përgjigjen pozitivisht kësaj kërkesë ligjore. Shumica dërrmuese e OJQ-ve kanë pasur së paku një (1) takim të organit më të lartë drejtues gjatë vitit 2017 (89%). Një numër i madh i organizatave kanë pasur dy takime të organit më të lartë drejtues (25.7%), derisa 42.6% e tyre e kanë pasur më shumë se dy takime të organit më të lartë drejtues. Vërehet një rritje e vogël, prej 3%, e numrit të organizatave që kanë pasur më shumë se dy takime të organit drejtues, në krahasim me të dhënat e Indeksit për vitin 2015, deri sa ka rënë numri i organizatave që nuk kanë pasur asnjë takim të organit drejtues, nga 13.5% sa ka qenë në edicionin e kaluar të Indeksit, në 9.9%.



(Figura 13: Shpeshtësia e takimeve të organeve më të larta drejtuese – Burimi: Anketa me OShC)

Për dallim nga të dhënat e Indeksit të kaluar, ku rreth 13% e OJQ-ve të regjistruara si fondacione patën deklaruar se ndonjëri prej anëtarëve të Bordit është edhe i punësuar në organizatë, të dhënat nga ky edicion tregojnë se asnjë fondacion nuk ka të punësuar anëtarë të Bordit në organizatë.

Ngjashëm me edicionin e kaluar por me një përkeqësim të shoqatave, duket se Kuvendi i Anëtarëve ka rol më të dobët udhëheqës në rastin e shoqatave sesa Bordet e fondacioneve. Konkretisht, më pak se 1/3 e shoqatave deklaruan se Kuvendi i Anëtarëve i merr vendimet kryesore të organizatës, në raport me mbi gjysmën e fondacioneve që e deklaruan Bordin si vendimmarrës kryesor.




(Figura 14, Organi i cili merr vendimet kryesore të organizatës – Burimi: Anketa me OShC)

## Dokumentet e brendshme dhe transparenca

Ngjashëm me edicionin e kaluar të Indeksit, organizatat më të konsoliduara deklarojnë që janë mirë të rregulluara sa i përket dokumenteve dhe procedurave të brendshme, edhe pse ngjashëm me të kaluarën, jo të gjitha i kanë treguar këto dokumente kur u është kërkuar.

Organizatat e konsoliduara që operojnë me buxhete të mëdha dhe që kanë shumë të punësuar pritet të kenë më shumë dokumente dhe procedura formale lidhur me punët e tyre të përditshme, ndërsa ato të voglat nuk kanë nevojë domosdo që të kenë procedura të detajuara apo burokraci të thellë për realizimin e aktiviteteve të tyre të përditshme. Edhe të dhënat nga anketa e konfirmojnë këtë konstatim. Rreth 38% e organizatave të anketuara deklaruan se nuk kanë rregullore financiare, rregullore të punës (24%), apo kod të mirësjelljes të personelit (39%). Megjithatë, nga një analizë e detajuar e të dhënave vërehet se në mesin e organizatave që kanë të hyra vjetore nga 10,000 EUR deri në 4 milion EUR, shumica dërrmuese e tyre posedojnë rregullore të punës, rregullore financiare, dhe kontrata të punës për stafin (90%).



(Figura 15: Ekzistimi e dokumenteve të brendshme – Burimi: Anketa me OShC)

Rrjetet sociale dhe zhvillimi i teknologjisë së komunikimit janë një aset tejet i rëndësishëm për komunikim për të gjithë sektorët, në përgjithësi, e në veçanti për OShC-të pasi që i mundësojnë një shtrirje më të madhe dhe mundësi të lehtë për komunikim me publikun, me një kosto tejet të ulët. Përkundër asaj, një numër i madh i OShC-ve vazhdojnë të mos kenë ueb faqe dhe as rrjete sociale. Në mesin e organizatave të anketuara, vetëm 27% e tyre deklaruan se kanë web faqe, derisa një numër pak më i madh thanë se posedojnë rrjete sociale (39.6%).

## Të punësuarit

Përkundër që një numër relativisht i madh i OShC-ve operojnë pa fonde, ky sektor ka një numër të konsiderueshëm të të punësuarave në radhët e veta. Megjithatë, shteti nuk ka politika apo legjislacion për t'i trajtuar nevojat e veçanta të këtij sektori.

Në mungesë të publikimit të të dhënave sistematike rreth sektorit të shoqërisë civile nga institucionet publike, njejtë sikurse në edicionet e kaluara të Indeksit, KCSF ka bashkëpunuar me FKPK dhe ATK për të siguruar të dhëna bazike për sektorin. Përkundër numrave të ndryshëm varësisht prej burimit dhe mungesës së hollësive lidhur me llojin e punësimit, prapëseprapë është e qartë se shoqëria civile vazhdon të jetë gjenerues mjaft i rëndësishëm i vendeve të punës dhe punëson një përqindje të konsiderueshme të të punësuarve në Kosovë. Të dhënat nga FKPK tregojnë se gjatë vitit 2017 OJQ-të në Kosovë kanë paguar kontribute pensionale për 17,940 kontribues<sup>3</sup>. Nëse marrim parasysh numrin prej 352,849 të kontribuesve aktivë në vitin 2017<sup>4</sup>, shoqëria civile përbën rreth 3.25% të numrit të përgjithshëm të kontribuesve të FKPK-së. Nga ky numër, 3,503 kontribues janë punësuar në shoqërinë civile për tërë 12 muajt e vitit 2017, ndërsa 7,049 kanë pasur edhe angazhime të tjera përveç atyre në OJQ<sup>5</sup> - e që ndryshe mund të interpretohet edhe si të punësuar me orar të pjesshëm apo për angazhime të shkurta në OJQ. Në përgjithësi, vërehet një rritje e lehtë si e numrit të të punësuarëve në OJQ për 12 muajt e vitit 2017, ashtu edhe e vlerës totale të kontributeve të paguara nga OJQ-të krahasuar me të dhënat e Indeksit për vitin 2015. Vërehet një rritje e theksuar e numrit të të punësuarëve të cilët kanë më shumë se një punë ku njëra punë është në OJQ, nga 4,142 sa ka qenë në vitin 2015, në 7,049 gjatë vitit 2017 (rreth 67%). Megjithatë, kjo rritje jo e natyrshme arsyetohet me faktin se gjatë vitit 2017 në Kosovë janë mbajtur dy palë zgjedhje, zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Si rrjedhojë, gjatë kësaj periudhe janë angazhuar mijëra monitorues të zgjedhjeve nga radhët e shoqërisë civile<sup>6</sup>, gjë e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e këtij numri.

Të dhënat e ATK-së tregojnë se 8,453 persona janë të punësuar<sup>7</sup> në gjithsej 816 OJQ gjatë vitit 2017. Në krahasim me vitin 2015 këto të dhëna tregojnë se ka më pak OJQ që kanë të punësuar (nga 927 sa ka qenë në 2015, në 816 në vitin 2017), mirëpo më shumë të punësuar – nga 6,412 që ishin në vitin 2015, në 8,453. Sidoqoftë, kjo rritje e madhe e numrit të të punësuarave gjithashtu mund të jetë e ndërlidhur me numrin e madh të monitoruesëve të zgjedhjeve që janë angazhuar nga OJQ-të gjatë vitit 2017.

Shpërndarja gjeografike e kontribuesve individual nga sektori i shoqërisë civile në përgjithësi është në përputhje me përhapjen gjeografike të OJQ-ve të regjistruara, ku Prishtina gjendet në majë të listës me 38% të kontribuesve, e përcjellur nga rajoni i Prizrenit me rreth 13%, Mitrovica me 12%, Peja me 9.4%, qendrat e tjera rajonale të Kosovës.

<sup>3</sup> Këtu përfshihen të gjithë kontribuesit nga sektori i OJQ-ve, përfshirë individë të njejtë të cilët gjatë vitit mund të jenë angazhuar nga dy ose më shumë OJQ.


<sup>4</sup> Raporti vjetor i FKPK, 2017 - [http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2017/12/RV2017\\_shq.pdf](http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2017/12/RV2017_shq.pdf)

<sup>5</sup> Të dhënat nga FKPK, (8 maj, 2018). Të dhëna të papërpunuara, Prishtinë, Kosovë.

<sup>6</sup> Hulumtimet shitesë tregojnë që vetëm dy rrjetet të monitorimit të zgjedhjeve kanë angazhuar mbi 7,000 vëzhgues gjatë zgjedhjeve qendrore 2017, zgjedhjeve lokale 2017 dhe balotazhit lokal 2017.


<sup>7</sup> Me orar të plotë dhe të pjesshëm/angazhim të shkurtë.

<sup>8</sup> Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës, maj 2017. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.



(Figura 16: Shpërndarja gjeografike e të punësuarve të OJQ-ve – Burimi: FKPK)


Për dallim prej sektorëve tjerë të punësimit në Kosovë, sektorin publik dhe privat, sektori joqeveritar ka një përbërje gjinore më të balancuar, me vlera të ngjashme sikurse para dy vitesh. Konkretisht, përdërisa edhe të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore edhe ato të FKPK-së tregojnë se në përgjithësi në Kosovë gratë nuk i arrijnë as 1/3 e numrit të të punësuarve, në OShC raporti është gati se i barabartë, me një dominim të lehtë të burrave (53.5% me 46.5%). Të dhëna të ngjashme dalin edhe nga Anketën me OShC, edhe pse ngjashëm me edicionin e kaluar, dallimi thellohet në favor të burrave kur bëhet fjalë për pozita menaxheriale në kuadër të sektorit jo-qeveritar.



(Figura 17: Shpërndarja gjinore e të punësuarve në shoqërinë civile dhe në sektorë të tjerë në vitin 2015 dhe 2017 – Burimi: FKPK)

## Rekrutimi i të punësuarve


Gjatë rekrutimit të stafit të organizatës, shumica e të anketuarëve deklaruan se përvoja e punës në fushën përkatës (67.3%) dhe kualifikimi arsimor për fushën përkatëse të punës (65.3%) janë dy kriteret kryesore të cilat i marrin parasysh. Poashtu, të dhënat nga anketa tregojnë se rëndësi i kushtohet edhe përvojës së punës në sektorin e shoqërisë civile (33%) apo referencave nga organizatat partnere (31%). Ndërsa, aftësitë bazike, si komunikim, puna në grup etj, u vlerësuan si kriterë më së paku të rëndësishme (2%).



■ Jo më shumë se 1 vit ■ 2 vite ■ 3-5 vite ■ Më shumë se 5 vite

Figura 18, Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Pas rekrutimit, OShC-të raportojnë se në përgjithësi stafi i tyre qëndron për një kohë relativisht të gjatë. Rreth 39% e OShC-ve deklaruan se stafi i tyre qëndron në organizatë më shumë se 5 vite, shifër kjo e cila paraqet një rritje të dukshme krahasuar me të dhënat e Indeksit për vitin 2015 (16.3%). Tridhjetë e tre përqind e të anketuarëve deklaruan se stafi i tyre qëndron në organizatë mesatarisht 3-5 vite, dhe nga 14% e OShC-ve thanë se stafi i tyre nuk qëndron në organizatë më shumë se dy vite, respektivisht një vit. Një zberthim i OShC-ve në bazë të të hyrave vjetore tregon se sa më të larta të hyrat vjetore të organizatës, aq më e madhe gjasa që stafi të qëndrojë kohë më të gjatë në organizatë. Poashtu, edhe organizatat që kanë deklaruar zero të hyra vjetore tregojnë kohëzgjatje të lartë të stafit në organizatë. Kjo e fundit mund të shpjegohet me faktin se definimi si punëtorë në OShC nuk do të thotë domosdo se ata paguhen në mënyrë të vazhdueshme. Kjo kategori e OShC-ve, zakonisht, përbëhet nga një ose disa individë të cilët identifikohen me organizatën për një kohë të gjatë, pavarësisht nëse kanë të hyra dhe paguhen ose jo.



(Figura 19, Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatë krahasuar me qarkullimin vjetor të OShC-ve për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)



## Kapacitetet e brendshme

Ngjashëm me edicionin e kaluar, madje me një rritje të lehtë, OShC-të vlerësojnë që kanë kapacitete shumë të mira në pjesën më të madhe të aftësive e shkathtësive të nevojshme për këtë sektor, me përjashtim të ngritjes së fondeve. Vlerësimin e njejtë nuk e ndajnë donatorët, të cilët megjithatë i vlerësojnë më të ulëta kapacitetet e sektorit në shumicën e kategorive. Aneka me OShC tregojnë për një vetëvlerësim të lartë të OShC-ve për sa i përket kapaciteteve organizative. Më konkretisht, të dhënat nga anketa tregojnë se 61.4% e OShC-ve kanë vlerësim të lartë për kapacitetet e tyre për menaxhim të organizatës, komunikim me publikun (61.4%), menaxhim financiar (53.5%), mobilizim të komunitetit (51.5%), dhe shkrim të projekt propozimeve (43.6%). Për dallim nga perceptimi i OShC-ve, donatorët në Kosovë vlerësojnë se OJQ-të kanë kapacitete të ulëta për sa i përket mobilizimit të komunitetit (60.7%), apo komunikimit me publikun (35.7%).

Në anën tjetër, gjetja e donatorëve vlerësohet si pjesa më problematike nga OJQ-të, ku rreth 24% e tyre deklaruan se kanë kapacitete të ulëta për të siguruar fonde për organizatën. Poashtu, të pyetur se cilat janë dobësitë kryesore të stafit të organizatës tuaj, gjetja e donatorëve dhe fondeve për organizatën u listua e para (26%). I njëjti perceptim konfirmohet edhe nga të dhënat e anketës me donatorë, ku 31% e donatorëve të anketuar e vlerësojnë si problematike gjetjen e donatorëve nga OJQ-të, më konkretisht sigurimin e bashkëfinancimit për projekte të caktuara.

Në përgjithësi, OShC - të kanë vlerësim të ngjashëm për kapacitetet e tyre krahasuar me të dhënat e Indeksit për vitin 2015, ku ndryshimi i vetëm më i vërejtshëm është ai për vlerësim të kapaciteteve për gjetje të fondeve, fushë në të cilën është rritur vlerësimi për kapacitete të tyre.

Pjesa dërrmuese e OShC-ve të anketuara e konsiderojnë stafin e tyre tejet të përgatitur dhe profesional. Më konkretisht, të pyetur nëse punonjësit e tyre janë të përgatitur profesionalisht, 74% e OShC-ve deklaruan se stafi i tyre është shumë i përgatitur profesionalisht për fushën dhe punën përkatëse, përderisa në edicionin e kaluar të Indeksit vetëm 56% ishin pajtuar me këtë konstatim. Megjithatë, anketa me donatorë tregon se një ndër çështjet më problematike me të cilën ballafaqohen OShC-të gjatë aplikimit apo zbatimit të projekteve janë resurset humane jo adekuate për zbatim të projekteve.





Figura 20: Vetëvlerësimi i kapaciteteve të brendshme të OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC)


## Rrjetëzimi dhe komunikimi

Dy trende të ndryshme vërehen gjatë dy viteve të fundit sa i përket rrjetëzimit dhe komunikimit në mes të OJQ-ve: organizatat e pa ekspozuara e kanë thelluar izolimin e tyre, përderisa ato me më shumë ekspozim e kanë rritur nivelin e rrjetëzimit dhe komunikimit në mes vete. Në anën tjetër, zhvillim pozitiv paraqet rritja e lehtë e nivelit të bashkëpunimit të OJQ-ve kosovare me organizata jashtë Kosovës.

Rreth gjysma e OShC-ve në Kosovë janë anëtarë në së paku një (1) rrjet, grup ombrellë ose federatë. Më konkretisht, 15.8% e OShC-ve janë anëtarë në vetëm një rrjet, rreth 12% bëjnë pjesë në 2 deri në 3 rrjete, përderisa 21.8% e tyre janë anëtarë në më shumë se katër rrjete. Krahasuar me të dhënat e Indeksit për vitin 2015, vërehet një rënie e bashkëpunimit të OShC-ve përmes rrjetëzimit në grupe ombrellë ose federata, përderisa sa ka një rritje të vërejtshme prej më shumë se 8%, të organizatave anëtarë në më shumë se 4 rrjete. Poashtu, në mesin e organizatave që janë anëtarë në rrjete të ndryshme, vërehet një rritje e komunikimit në mes të anëtarëve të rrjetit, qoftë përmes takimeve, apo shkëmbimit të e-mailave për çështje të fushëveprimtarisë. Rreth 96% e organizatave të anketuar deklaruan se janë takuar së paku një herë gjatë vitit 2017, dhe atë, gjysma e tyre thanë se kanë pasur më shumë se gjashtë (6) takime.



[Figura 21: Rrjetëzimi i OShC-ve – Burimi: Anketa me OShC]



[Figura 22. Frekuenca e takimeve të OShC-ve me anëtarët e rrjetit/rrjeteve – Burimi: Anкета me OShC]

Duke pasur parasysh se rrjetëzimi formal është vetëm njëra nga mënyrat e punës së përbashkët, në studim gjithashtu është analizuar niveli i ndërveprimit dhe komunikimit mes OShC-ve në Kosovë dhe jashtë saj. Të pyetur se sa organizata që veprojnë brenda Kosovës dhe/ose jashtë Kosovës në fushën tuaj apo të ngjashme me organizatën tuaj i njihni, 20% e të anketuarëve u përgjigjen se nuk e njohin asnjë organizatë të tillë brenda Kosovës, respektivisht 32% jashtë Kosovës. Krahasuar me të dhënat e edicionit të kaluar të Indeksit, është rritur lehtë numri i organizatave që bashkëpunojnë me organizata tjera jashtë Kosovës, përdërisa ka rënë numri i organizatave që bashkëpunojnë me organizata tjera në Kosovë.


## Angazhimi i qytetarëve

### Aktivizmi qytetar

Pas shumë vitesh, angazhimi i qytetarëve në shoqëri civile rezulton me ndryshime më të theksuara. Edhe pse vazhdojnë të mbeten të ulëta, janë rritur përqindjet e qytetarëve të anëtarësuar apo që bëjnë punë vullnetare në OShC, sikurse edhe përfitimet nga shërbimet që ofrohen nga shoqëria civile. Në anën tjetër, ka një ulje të lehtë të besimit të qytetarëve në shoqëri civile dhe vlerësimin e punës së këtij sektori.

Aktivizmi qytetar mund të shprehet në forma të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në angazhimin në organizata të shoqërisë civile. Për të matur nivelin e angazhimit të qytetar në Kosovë, mostra përfaqësuese për Kosovë prej 1,306 respondentësh janë pyetur nëse janë anëtarë apo bëjnë punë vullnetare për ndonjë organizatë të shoqërisë civile ose parti politike.

Në përgjithësi, numër i vogël i qytetarëve të Kosovës janë anëtarë në organizata të shoqërisë civile apo parti politike. Të dhënat nga anketa tregojnë se afër 11.5% e qytetarëve të Kosovës janë anëtarë të një ose më shumë organizatave të shoqërisë civile, dhe 15.2% deklaruan se kanë bërë punë vullnetare për organizata të shoqërisë civile gjatë vitit 2017. Në anën tjetër, 13% e respondentëve deklaruan se janë anëtarë të një partie politike, dhe 10.7% e tyre thanë të kenë bërë punë vullnetare për një parti politike gjatë vitit 2017. Për dallim nga të dhënat e Indeksit për vitin 2015, vërehet një rritje e konsiderueshme e përqindjes së qytetarëve që deklarojnë të jenë anëtarë të organizatave të shoqërisë civile.




(Figura 23. Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete publike – Burimi: Pulsi Publik XIV i UNDP-së)

Trend pozitiv vërehet edhe tek numri i qytetarëve që kanë përfituar nga shërbimet e ofruar nga shoqëria civile, nga 3.4% sa ka qenë në vitin 2015, në 9.2%. Edhe pse arsyet e sakta për këtë rritje të aktivizimit qytetar dhe ndërveprimin të qytetarëve me OShC nuk mund të identifikohen, zgjedhjet – ato qendrore dhe lokale – mund të jenë një ndër faktorët që e ka shkaktuar këtë rritje. Kjo për faktin se një numër i madh i qytetarëve të Kosovës, rreth 2,000, angazhohen si monitorues të zgjedhjeve nga radhët e OShC-ve, si dhe, OShC-të kanë një kontribut aktiv dhe domethënës në informimin e qytetarëve rreth procedurave të votimit, raportimit rezultateve dhe parregullsive eventuale gjatë proceseve zgjedhore.

Edhe pse trend në rritje e sipër, anëtarësimi i qytetarëve në OShC vazhdon të mbetet i ulët, duke sugjeruar në një apati të thellë qytetare, por edhe mungesë të komunikimit të vet shoqërisë civile me qytetarë dhe përfshirjes së tyre në punën e sektorit. Në një analizë më të detajuar të të dhënave nga anketa me qytetarë del se anëtarësimet në organizata të shoqërisë civile janë të baraspeshuara në aspektin gjinor, përderisa tek partitë politike vërehet një numër, gati, trefish më i madh i burrave në raport me gra.

Në anën tjetër, të dhënat nga anketa tregojnë për një rënie të lehtë të besimit të qytetarëve tek shoqëria civile, sikurse edhe vlerësimin të punës që këto organizata bëjnë. Më konkretisht, të dhënat në edicionin e kaluar të Indeksit tregojnë se 59% e qytetarëve të Kosovës u besonin organizatave të shoqërisë civile, për dallim prej 52.6% të qytetarëve që e deklaruan të njejtën në këtë edicion. Ngjashëm qëndron edhe vlerësimi që qytetarët kanë për punën e OShC-ve, i cili nga 60.7% sa ka qenë në vitin 2015, ka rënë në 47.9%.




(Figura 24, Angazhimi i qytetarëve dhe mendimi i tyre për shoqërinë civile në vitet 2013, 2015 dhe 2017 – Burimi: Pulsit publik XIV i UNDP-së)

Është mjaft domethënëse edhe rënia e përqindjes së qytetarëve të cilët kanë deklaruar të kenë përkrahur ndonjë çështje të ngritur nga shoqëria civile, nga rreth 21% që ka qenë në dy edicionet e kaluara në 16.2% në këtë edicion. Kjo e dhënë është konsistente me rezultatet e angazhimit të shoqërisë civile në politikë-bërje, të cilat gjithashtu janë në rënie, dhe sugjeron një ulje të përgjithshme të angazhimit të sektorit në ngritje të çështjeve të ndryshme shoqërore.

## Vullnetarizmi


Vullnetarizmi në organizata të shoqërisë civile është rritur dukshëm krahasuar me dy vite më parë, edhe pse përqindja e organizatave që kanë angazhuar vullnetarë ka pësuar rënie. Të gjitha këto zhvillime vazhdojnë të ndodhin në një ambient të pafavorshëm për zhvillimin e vullnetarizmit.

Përkundër disa përpjekjeve të organizatave të ndryshme për të ndërtuar një sistem për regjistrim të vullnetarëve dhe punës së tyre, vlerësimi i angazhimit vullnetar në shoqëri civile vazhdon të mbetet i vështirë. Nuk ka sistem funksional me të dhëna gjithëpërfshirëse për numrin e vullnetarëve, numrin e orëve të punës vullnetare, llojet e punës vullnetare apo demografinë e vullnetarëve. Andaj, të dhënat për punë vullnetare janë grumbulluar përmes anketës me OShC, dhe anketës së Pulsit Publik të UNDP-së.



(Figura 25: Perceptimet e OShC-ve për trendët e vullnetarizmit në shoqërinë civile gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)


Perceptimi i OShC-ve për trendin angazhimit vullnetar në Kosovë mbetet kryesisht i pandryshuar. Rreth 38% e OShC-ve të anketuara deklaruan se angazhimi vullnetar në shoqëri civile mbetet i njejtë krahasuar me vitin paraprak, deri sa 27% e tyre thanë se angazhimi vullnetar ka pasur rritje në vitin 2017, dhe rreth 18% mendojnë se puna vullnetare në këtë sektor ka shënuar rënie. Megjithatë, anketa me qytetarë të Kosovës tregon për një rritje relativisht të madhe të punës vullnetare për organizata të shoqërisë civile. Rreth 15% e qytetarëve të Kosovës deklaruan se kanë bërë punë vullnetare për një ose më shumë OShC gjatë vitit 2017. Krahasuar me vitin 2015, kjo shënon një rritje prej rreth 11%.



(Figura 26, Angazhimi i qytetarëve në punë vullnetare – Burimi: Pulsi publik i UNDP-së)


Anketa me OShC tregon se organizatat e shoqërisë civile janë skeptike për politikën e vullnetarizimit dhe kornizën ligjore relevante, dhe një pjesë e madhe e tyre nuk kanë fare njohuri për një gjë të tillë. Pak më shumë se një e treta e OShC-ve të anketuara mendojnë se korniza ligjore dhe e politikave për angazhim të vullnetarëve është stimuluese (6%) ose deri diku stimuluese (32.7%). Në anën tjetër, 11.9% e OShC-ve deklaruan se në Kosovë nuk ka kornizë ligjore dhe as politika për punë vullnetare, dhe 26.7% deklaruan të mos kenë njohuri për një gjë të tillë.

Megjithatë, përkundër punës në një mjedis ku puna vullnetare nuk është e rregulluar e as nuk promovohet, OShC-të e Kosovës angazhojnë numër të konsiderueshëm të vullnetarëve. Edhe pse përqindja e organizatave që kanë angazhuar vullnetarë ka një rënie të lehtë gjatë vitit 2017, OShC-të vazhdojnë të angazhojnë dukshëm më tepër vullnetarë sesa staf me pagë.




(Figura 27, Angazhimi i vullnetarëve nga OShC-të – Burimi: Anketa me OShC)

Anketa me OShC tregon se raporti i vullnetarëve me stafin që merr ndonjë lloj page prej organizatës është një me katër. Më konkretisht, për çdo anëtar të stafit me pagë, një OShC ka katër vullnetarë.



(Figura 28: Numri i vullnetarëve krahasuar me numrin e punëtorëve me paga në OShC-të e anketuara, gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Forma e angazhimit të vullnetarëve, në masë të madhe, mbetet joformale. Nga OShC-të e anketuara që kanë angazhuar vullnetarë, vetëm një pjesë e tyre këtë e kanë bërë përmes kontratave me shkrim (25.5%), ndërsa të tjerët në mënyra të ndryshme jo-formale.”



(Figura 29, Forma e angazhimit të vullnetarëve në OShC – Burimi: Anketë me OShC)

## Financimi


### Qarkullimi vjetor

Të dhënat në dispozicion tregojnë që trendi i financimit në shoqëri civile është në rënie në krahasim me dy vite më parë, në të gjithë indikatorët që e mbulojnë këtë fushë.

Në mungesë të të dhënave sistematike dhe zyrtare për të hyrat e sektorit, analiza në këtë pjesë bazohet në anketën me OShC, ndërsa për konfirmim shfrytëzohen edhe të dhënat e marra nga ATK dhe anketa me donatorë. Të dhënat nga anketa tregojnë se gati gjysma e OShC-ve në Kosovë veprojnë pa fonde fare (46%), deri sa pjesa më e madhe e OShC-ve që kanë deklaruar të kenë pasur të hyra vjetore bëjnë pjesë në kategorinë nën 10,000 EUR në vit (23%). Pjesa tjetër e respondentëve janë të shpërndarë në kategoritë tjera deri në 500,000 EUR në vit, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e organizatave raportojnë të hyra vjetore mbi këtë shumë. Të dhëna të ngjashme, me dallime të vogla, paraqiten edhe nga Deklaratat Vjetore të dorëzuara nga OShC-të në Administratën Tatimore të Kosovës<sup>9</sup>.


<sup>9</sup> Të dhënat zyrtare nga Administrata Tatimore e Kosovës, maj 2017. Të dhëna të papërpunuara. Prishtinë, Kosovë.






(Figura 30, Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Krahasuar me të dhënat e Indeksit për vitin 2015, anketa me OShC tregon për një trend në rënie të financimit të OShC-ve. Kjo më së shumti vërehet tek organizatat të cilat kanë deklaruar zero të hyra vjetore në vitin 2015 (32%), për dallim nga të dhënat e anketës për edicionin aktual të Indeksit që shënon rritje në 46%. Më konkretisht, vërehet një rritje prej 14% e organizatave që veprojnë pa fonde. Derisa kategoritë tjera të të hyrave vjetore kanë mbetur afërsisht të njëjta, vërehet rënie e numrit të organizatave me të hyra vjetore nga 10,001 – 25,000 EUR dhe të atyre me të hyra vjetore nga 100,001 – 500,000 EUR. Një tregues tjetër për këtë trend negativ është edhe numri i organizatave që nuk kanë arritur të sigurojnë fonde të mjaftueshme për të siguruar vazhdimësinë e punës së tyre (72%), për dallim nga 62% sa ka qenë në vitin 2015. Poashtu, vërehet një rritje e organizatave që nuk kanë zbatuar asnjë projekt gjatë vitit 2017 (47.5%), derisa më pak organizata kanë pasur 1 deri në 4 projekte (38.7%), dhe 5 deri në 10 projekte (11%).




(Figura 31, Numri i projekteve në zbatim të OShC-ve për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Në anën tjetër, të pyetur nëse të hyrat e organizatës kanë ndryshuar ose jo krahasuar me vitin e kaluar, 48.5% e respondentëve deklaruan se ato kanë mbetur të njëjta, ndërsa 29% deklaruan që kanë pasur më pak të hyra në raport me ata që deklaruan rritje të të hyrave (13%). Krahasuar me edicionin e kaluar të Indeksit, ndryshimi kryesor është në kategorinë e organizatave që kanë deklaruar se të hyrat e organizatës së tyre janë rritur – nga 23% sa ka qenë në vitin 2015, në 13% në vitin 2017 - përderisa kategoritë tjera kanë mbetur afërsisht të njëjta.



(Figura 32, Trendi i të hyrave të OShC-ve në vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Trendi negativ i financimit të sektorit në përgjithësi paraqitet edhe te mjaftueshmëria e fondeve për të vijuar punën e planifikuar të organizatës. Edhe pse për kohë të gjatë tashmë vetëm një pjesë e organizatave arrijnë të sigurojnë fonde të mjaftueshme për të vazhduar me punën e planifikuar, kjo përqindje ka rënë në vitin 2017 (27.7%) në krahasim me vitin 2015 (37%).



(Figura 33, Numri i OShC-ve që kanë arritur të sigurojnë mjaftueshëm fonde për të siguar vazhdimësinë e punës së organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

## Burimet e financimit

Llogaritja e përqindjeve të burimeve të financimit të shoqërisë civile mbetet ndër sfidat kryesore, si rrjedhojë e mungesës së të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të sakta, qoftë prej institucioneve publike, ashtu edhe prej donatorëve të huaj, të cilët mbesin donatorët kryesorë të këtij sektori në Kosovë. Për shumë vite me radhë, Indeksi ka pyetur OShC-të për burimet e tyre të financimit në bazë të kategorive specifike të financimit.

Njejtë sikurse në edicionet e kaluara të Indeksit, të dhënat nga anketa tregojnë se donatorët e huaj vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit për OShC në Kosovë, edhe pse në përqindje kanë pësuar rënie të dukshme. Në anën tjetër, fondet publike janë burimi i dytë më i rëndësishëm dhe me një rritje të dukshme krahasuar me vitin 2015. Burimet tjera të financimit mbesin relativisht të ulëta<sup>10</sup>.





Figura 34, Burimet e financimit të sektorit të shoqërisë civile për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Megjithatë, kur analizohet shpërndarja e fondeve, vërehet që donatorët e huaj i ndajnë fondet e tyre te një grup më i vogël i organizatave (22.8%) në krahasim me para dy vitesh (38.6%), ndërsa trendi i kundërt është te fondet publike, ku më shumë organizata kanë marrë fonde publike në vitin 2017 (33.6%) sesa në vitin 2015 (27.7%). Burimet tjera të financimit janë më pak të shprehura, ndërsa ndryshimet kryesore vërehen te rritja e përqindjes së organizatave që kanë tarifa të anëtarësisë dhe rënie % të organizatave që kanë pranuar donacione nga individët.

<sup>10</sup> Burimet e financimit masin përqindjen e një burimi të caktuar në organizatat e shoqërisë civile pavarësisht shumës së fondeve, duke i dhënë peshë të njejtë sikur OShC-ve me shumë pak buxhet ashtu edhe atyre me buxhet të lartë. P.sh. nëse një OShC që punon me 2,000 Euro në vit financohet 100% nga fondet publike, kjo përqindje ka të njejtën peshë sikurse përqindja e një OShC-je me 100,000 Euro në vit që financohet 100% nga donatorët e huaj.



(Figura 35: OShC-të sipas burimeve të financimit për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC)

Në anën tjetër, është rritur dukshëm përqindja e organizatave të cilat kanë deklaruar të mos kenë pranuar fonde gjatë vitit 2017 (45.5%), në krahasim me vitin 2015, kur ishin vetëm 31.7%.

## Kohëzgjatja e financimit dhe planifikimi i punës

Rezultatet e edicioneve të kaluara që tregojnë mungesën e konsiderueshme të planifikimit të punës së OShC-ve janë përsëritur edhe në këtë edicion, ngjashëm sikurse që është përsëritur ndërlidhja e planifikimit të punës me kohëzgjatjen e përkrahjes financiare për këto organizata.





Figura 36, Kohëzgjatja e planifikimit të punës së OShC-ve për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Të dhënat nga anketa me OShC tregojnë se OShC-të në Kosovë, në përgjithësi, planifikimin e punës së tyre e bëjnë për periudha të shkurta kohore. Pjesa dërrmuese (78.2%) deklaruan se planifikimin e punës së organizatës e bëjnë për periudhë kohore jo më shumë se 12 muaj – shifër kjo e cila është pothuajse identike me të dhënat e edicionit të kaluar të Indeksit (79%). Në anën tjetër, vërehet një rritje e lehtë e numrit të organizatave që planifikimin e punës e bëjnë për periudha kohore nga 24 deri në 36 muaj (6.9%), apo për më shumë se 36 muaj (8.9%).



(Figura 37: Raporti ndërmjet planifikimit të punës së organizatës me kohëzgjatjen e projekteve – Burimi: Anketa me OShC)

Në anën tjetër, respondentët janë pyetur për kohëzgjatjen e kontratave të përkrahjes financiare të shumave të ndryshme dhe rezultatet janë të ngjashme me edicionet e kaluara. Përdërisa përsëri dominojnë kontratat afat-shkurtra (68.1% të totalit të kontratave të deklaruara nga organizatat e anketuara), natyrshëm rezultojnë se sa më e lartë shuma e kontratës aq më e gjatë edhe koha e zbatimit. Gjithashtu, analiza e thelluar i konfirmon supozimet që planifikimi i punës së organizatës ndërlikohet drejtpërdrejtë me kohëzgjatjen e kontratave të përkrahjes financiare.

## Llojet e përkrahjes

Ndryshimi kryesor gjatë dy viteve të fundit në llojet e përkrahjes për OShC ka të bëjë me rritjen e përkrahjes institucionale, edhe pse përkrahja për projekte në shuma të vogla dhe për periudh afat shkurtë mbetet lloji kryesor i përkrahjes.

Ngjashëm me të kaluarën, nga të gjitha kontratat e raportuara nga organizatat e anketuara vazhdojnë të dominojnë kontratat me vlera më të ulëta, kryesisht nën 10,000 EUR (38.3%) dhe nga 10,000 Euro deri në 25,000 Euro (19.1%). Rezultate të ngjashme dalin edhe nga anketa me donatorët, ku nga të gjitha kontratat e raportuara nga ta, dominojnë këto me vlera të ulëta. Megjithatë, përgjigjet e donatorëve i rendisin si më të shpeshtat kontratat nga 10,000 deri në 25,000 Euro (38.2%).




Figura 38, Qarkullimi vjetor i OShC-ve për vitin 2017 – Burimi: Anketa me OShC dhe Anketa me Donatorë

Anketa me donatorë tregon edhe një rezultat interesant në krahasim me periudhën e para dy viteve, e që është rritja e financimit institucional si formë e financimit për OShC. Gjithashtu, edhe pse vazhdojnë të jenë dominante, vërehet rënie e granteve për projekte afatshkurtëra. Të dyja këto mund të jenë disa nga arsyet e rritjes së lehtë të përqindjes së organizatave që bëjnë planifikim më afatgjatë të punës së tyre.




Figura 39, Lloji i përkrahjes së dhënë OShC-ve nga donatorët e huaj gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me donatorë

Forma më e zakonshme përmes së cilës OShC-të marrin fonde prej donatorëve vazhdon të jetë thirrja e hapur për aplikim, e cila rezulton të ketë qenë mënyra e marrjes së 72.5% të kontratave të raportuara nga organizatat e anketuara. Dominimi i kësaj forme konfirmohet edhe nga anketa me donatorë. Në anën tjetër, krahasuar më edicionin e kaluar të Indeksit, më pak OShC deklaruan të jenë ftuar drejtpërsëdrejti nga donatori për të aplikuar për fonde ose të kenë kërkuar fonde drejtpërsëdrejti nga donatori për përkrahje të projekteve të tyre.




Figura 40, Lloji i procedurave të aplikimit për fondet e huaja gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Sa i përket procedurave për aplikim për fonde, shumica e OShC-ve të anketuara i vlerësojnë ato si mesatarisht të vështira në raport me shumën e grantit për të cilën kanë aplikuar (56.7), 33.3% i vlerësojnë ato si të vështira, dhe vetëm 7.8% deklaruan se procedurat për aplikim për fonde janë të lehta. Nga një analizë krahasuese në mes të organizatave që kanë pasur fonde dhe atyre që nuk kanë pasur fare të hyra gjatë 2017, vërehet se në mesin e respondentëve me fonde, shumë më shumë organizata i vlerësojnë procedurat për aplikim për fonde të lehta (27%), deri sa 41% e organizatave që nuk kanë pasur të hyra gjatë 2017 i vlerësojnë procedurat e aplikimit për fonde si të vështira.




Figura 41, Vlerësimi i donatorëve lidhur me procedurat e aplikimit për fonde të huaja gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me donatorë

Në anën tjetër, donatorët kanë vlerësim relativisht të ndryshëm kur është fjala për procedurat e tyre për aplikim për fonde. Më shumë se gjysma e donatorëve deklaruan se procedurat për aplikim për grante i vlerësojnë si të lehta (53.3%), dhe rreth 26% deklaruan se kanë procedura deri diku të vështira.

Aplikimi në gjuhën angleze për shumë vite është raportuar si një nga problemet kryesore të organizatave, sidomos atyre më të vogla. Anketa me donatorë konfirmon që gjuha dominante e aplikimit të donatorët e huaj vazhdon të mbetet gjuha angleze, e cila aplikohet te gati 90% të donatorëve të anketuar, ndërsa rreth 1/3 e tyre pranojnë aplikacione edhe në gjuhën shqipe ose serbe.

## Programimi i fondeve të donatorëve

Kur i programojnë fondet e tyre, shumë donatorë të huaj i ftojnë për konsultim organizatat vendore, dhe trendi është në rritje krahasuar me dy vite më parë. Megjithatë, kryesisht ftohen për konsultim një grup i ngushtë i organizatave, ndërsa shprehja e interesimit nga vet organizatat për t'u konsultuar është në rënie.

Anketa me donatorë tregon një trend në rritje të përfshirjes së OShC-ve në programimin e fondeve të donatorëve. Shumica dërrmuese e donatorëve të anketuar deklaruan se i konsultojnë OShC-të gjatë programimit të fondeve, dhe atë, rreth 38% e tyre thanë se këtë e bëjnë çdo herë kur programojnë apo rishikojnë skema programore, 48% deklaruan se vetëm kohë pas kohë i ftojnë OShC-të për konsultim rreth programimit të skemave të tyre, deri sa vetëm 13.8% e tyre thanë se nuk i ftojnë OShC-të fare për konsultim.

Pjesa më e madhe e donatorëve deklaruan se OShC-të, në përgjithësi, i përgjigjen pozitivisht ftesës për konsultim, si dhe kontributi i tyre është i kënaqshëm. Rreth 78% e donatorëve të anketuar thanë se shumica e organizatave të ftuara i përgjigjen pozitivisht ftesës së tyre për konsultim, dhe se në përgjithësi janë të kënaqur me kontributin e OShC-ve në këto procese konsultative (33.3%), apo deri diku të kënaqur 67%. Poashtu, edhe nga këndvështrimi i OShC-ve, procesi i konsultimit nga donatorët vlerësohet pozitivisht. Një pjesë shumë e madhe e OShC-ve deklaruan se kur donatorët i konsultojnë për programim të skemave të tyre, kontributi i tyre merret parasysh plotësisht (23.5%), apo deri diku (64.7%).




Figura 42, Llojet e OShC-ve të cilat ftohen nga donatorët e huaj për programimin e fondeve të tyre – Burimi: Anketa me donatorë



Megjithatë, rezultatet e anketës i shpërfaqin dy sfida të rëndësishme. Të pyetur se cilat OShC i konsultoni zakonisht, më shumë se gjysma e donatorëve deklaruan se i konsultojnë vetëm disa organizata me të cilat bashkëpunojnë zakonisht (54%), dhe OShC të konsoliduara dhe të specializuara në fusha të caktuara (60.8%). Kjo konfirmohet edhe nga anketa me OShC, pasi që në mesin e organizatave që nuk kanë pasur fonde gjatë vitit 2017, vetëm 2% e tyre janë ftuar për konsultim nga donatorët, ndërsa shumica e OShC-ve me të hyra vjetore mbi 100,000 EUR janë ftuar së paku një herë për konsultim nga donatorët.

Në anën tjetër, shumë pak OShC kanë kërkuar të konsultohen nga donatorët. Vetëm 23.8% të OShC-ve të anketuara kanë kërkuar të konsultohen nga ndonjë donatorë gjatë vitit 2017. Kjo paraqet një trend negativ, gati të përgjysmuar, krahasuar me të dhënat e Indeksit 2015 (40%). E njëjta konfirmohet edhe nga anketa me donatorë, ku rreth 68% e të anketuarëve deklaruan se nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për konsultim nga OShC-të. Poashtu, e rëndësishme të theksohet, rreth 91% e OShC-ve me zero të hyra vjetore nuk kanë kërkuar asnjëherë të konsultohen nga donatorët gjatë vitit 2017.

## Fondet e BE-së

Një kapitull i veçantë i është kushtuar fondeve Bashkimit European (BE) për dy arsye, 1) BE është një ndër donatorët e huaj më të mëdhenj në Kosovë, dhe 2) Kosova ka për synim strategjik anëtarësimin në BE, ndërsa fondet e BE-së për shoqëri civile i shërbejnë avancimit të këtij procesi.

Krahasuar me dy vite më parë, të dhënat tregojnë për një trend në rënie të organizatave që kanë aplikuar për fonde të BE-së apo që kanë marrë financim nga ky institucion.




Figura 43, Aplikimi i OShC-ve për fonde të BE-së për vitet 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Rreth 73% e OShC-ve të anketuara deklaruan se nuk kanë aplikuar fare për fonde të BE-së, deri sa vetëm 11% e respondentëve thanë të kenë përfituar nga këto fonde. Respondentët të cilët kanë aplikuar për fonde të BE-së gjatë vitit 2017 janë pyetur nëse kanë hasur në sfida gjatë aplikimit ose jo. Procedura e komplikuar e aplikimit duket të jetë sfida kryesore me të cilën OShC-të vazhdojnë të ballafaqohen kur aplikojnë për fonde të BE-së (33.3%), e përcjellur nga vështirësitë për të siguruar bashkëfinancim për projektin e tyre (20%) – kërkesë kjo specifike për shumicën e projekteve që financohen nga BE. Nga 13% e respondentëve, si sfida poashtu janë përmendur edhe informatat e pamjaftueshme rreth procedurave të aplikimit, pamundësia për të aplikuar në gjuhë tjera përveç asaj angleze, si dhe kërkesat e larta në burimet njerëzore dhe kapacitetet për zbatim.

Një analizë më e thellë e të dhënave tregon se përfituesit kryesorë të fondeve të BE-së janë organizatat e konsoliduara, si në aspektin organizativ, të specializimit në fushën në të cilën veprojnë, ashtu edhe të të hyrave vjetore. Në anën tjetër, BE viteve të fundit gjithnjë e më shumë ka shfrytëzuar organizata ndërmjetëse për të ri-grantuar fondet e tyre, me qëllim të procedurave më të lehta dhe depërtimit edhe te organizatat më të vogla. Megjithatë, numri i përfituesëve mbetet mjaft i ulët në raport me numrin e përgjithshëm të organizatave të shoqërisë civile, duke e lënë BE-në ende ndër donatorët e përshtatshëm për organizatat e konsoliduara, por jo edhe ato të vogla.

## Fondet publike

Krahasuar me dy vite më parë, vërehet një rritje e lehtë e organizatave që kanë pranuar fonde publike, sikurse edhe trend pozitiv në thirrjet e hapura për aplikim dhe monitorim të zbatimit të këtyre fondeve.

Fondet publike për shoqërinë civile mbesin shumë problematike sa i përket transparencës dhe qasjes strategjike. Pas viteve të tëra të ndarjes së fondeve publike për OShC pa ndonjë planifikim, kriter ose transparencë, në qershor të vitit 2017, Qeveria e Kosovës ka miratuar Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OShC-ve. Kjo rregullore përcakton qartë procedurën për dhënie të mbështetjes financiare për OShC dhe ka karakter obligativ për zbatim për të gjitha organizatat buxhetore publike. Edhe pse ka prodhuar një situatë më pozitive sesa para se të aprovohej, gjatë vitit të parë niveli i zbatimit të rregullores është shumë i ulët.

Të dhënat nga anketa me OShC tregojnë një rritje të numrit të organizatave që kanë përfituar nga fondet publike, si dhe trend pozitiv të dhënies së fondeve publike përmes thirrjes së hapur për aplikim. Nga OShC-të e anketuara, rreth 31% e tyre deklaruan se kanë marrë fonde publike, për dallim prej 25% sa patën deklaruar të kenë marrë fonde publike në edicionin e kaluar të Indeksit. Në një situatë kur shumica e trendeve tjera që lidhen me financimin e OShC-ve janë negative, ky trend pozitiv bëhet edhe më domethënës. Shumica dërrmuese e të anketuarëve thanë se fondet publike i kanë marrë si përkrahje për projekt apo ndonjë aktivitet specifik të organizatës (76.5%), ndërsa 20.6% e tyre deklaruan se këto fonde i kanë marrë si financim institucional për organizatën – gjë kjo e cila poashtu shënon një rritje prej rreth 8% krahasuar më të dhënat nga Indeksi 2015.




Figura 44, Lloji i procedurave të aplikimit për fondet publike gjatë vitit 2015 dhe 2017 – Burimi: Anketë me OShC

Për më tepër, OShC-të u pyetën edhe për procedurat e aplikimit, respektivisht formën përmes së cilës i kanë marrë fondet publike. Duke shënuar trend pozitiv, 78% e tyre deklaruan se fondet publike i kishin marrë përmes thirrjeve të hapura për aplikim, dhe rreth 19% e OShC-ve thanë se kishin kërkuar financim direkt tek institucionet. Duke pasur parasysh që është rritur dukshëm numri i organizatave që kanë marrë fonde publike përmes thirrjes së hapur krahasuar me vitin 2015, dhe poashtu ka trend në rënie të dhënies së fondeve pa thirrje publike, këto mund të jenë tregues për efektet fillestare pozitive të rregullores për fonde publike.




Figura 45, Shuma e kontratave për fonde publike – Burimi: Anketë për OShC

Pjesa dërrmuese e kontratave për fonde publike nuk e kalojnë totalin prej 10,000 EUR (rreth 90%), ndërsa shumë më pak bëjnë pjesë në kategorinë 10,001 – 25,000 EUR ose 25,001 – 50,000 EUR.

Një përparim është vërejtur tek monitorimi i organizatave të cilat kanë marrë fonde publike, ku vetëm 5.6% e të anketuarëve deklaruan se nuk janë monitoruar fare, për dallim të 12% të organizatave sa patën deklaruar një gjë të tillë në Indeksin për vitin 2015. Në anën tjetër, kemi një rënie të lehtë të organizatave të cilat kanë deklaruar që kanë dorëzuar raporte të detajuara të aktiviteteve e shpenzimeve, nga 76% në vitin 2015 në 66.7% në vitin 2017.




Figura 46, Kontratat për fonde publike në bazë të nivelit qeverisës – Burimi: Anketa me OShC dhe Raporti i Qeverisë për vitin 2017

Nga një analizë më e detajuar e kontratave të raportuara nga organizatat e anketuara del se më shumë kontrata për financim publik vijnë nga niveli qendror (61.8%) sesa nga niveli lokal (38.2%). Kjo konfirmohet edhe nga Raporti i Qeverisë për fonde publike për OShC për vitin 2017, sikurse që konfirmohen edhe dominimi i pagesave në vlera të ulëta dhe një rritje e fondeve publike për OShC në përgjithësi.

## Kontratat shtetërore për shërbime publike

Edhe pse janë obligim i institucioneve shtetërore, pjesa më e madhe e shërbimeve publike që ofrohen nga OShC-të fatkeqësisht vazhdojnë të mbulohen nga fondet e donatorëve të huaj dhe jo nga shteti, ngjashëm me dy vite më parë.

Në përgjithësi, vetëm një numër i vogël i OShC-ve deklaruan se kanë aplikuar për kontrata shtetërore përmes prokurimit publik gjatë vitit 2017 (7%).

Të pyetur nëse kanë hasur në ndonjë pengesë gjatë aplikimit për kontrata shtetërore, OShC -të e anketuara thanë se ndër pengesat kryesore janë, kërkesat e shumta administrative (33.3%), të përcjellur nga procedurat e komplikuar të licencimit për shërbimet e ofruara (16.7%), dhe kërkesa të shumta të kriterëve të përzgjedhjes të cilat kanë favorizuar bizneset (17%).

Ndërsa, vetëm një rast i një organizate që ka aplikuar për këtë lloj kontrate u ankua për mos lejim konkurrimi, pa ju dhënë shpjegime specifike apo objektive për arsyet e mos lejit.

Sa i përket monitorimit të shpenzimeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara nga organizata, OShC-të të cilat kanë zbatuar kontrata të tilla, në përgjithësi, janë të kënaqura. Përkundër që numër i vogël i organizatave që kanë marrë kontrata për shërbime nga autoritetet shtetërore, vërehet se monitorimi i këtyre kontratave nga autoritetet shtetërore është i rregullt, me shumicën dërrmuese të organizatave të kontraktuara që e raportuan një monitorim të tillë.

Në përgjithësi, perceptimi nëse kontratat shtetërore jepen në mënyrë të drejtë dhe transparente ose jo, është kryesisht negativ (40.6%). Vetëm 11% e OShC-ve mendojnë se këto kontrata jepen në mënyrë të drejtë dhe transparente, deri sa gati gjysma e të anketuarëve janë deklaruar se nuk kanë njohuri për një gjë të tillë (49%). Të pyetur se ku e bazojnë këtë mendim, pjesa më e madhe deklaruan se mendimi bazohet në përvojën personale/të organizatës (32.7%), ose nga biseda me të tjerë dhe përvojat e organizatave tjera (33.7%).

## Përkrahja jofinanciare

Ngjashëm me dy vite më parë, përkrahja jo-financiare për OShC vazhdon të mbetet në nivel të ulët, me shumicën e organizatave që nuk kërkojnë diçka të tillë, dhe me shfrytëzim afat-shkurtë të hapësirave publike si forma më e shprehur e përkrahjes jo-financiare.




Figura 47. Aplikimi për kontrata shtetërore përmes prokurimit publik gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Në Kosovë nuk kemi ndonjë politikë apo kornizë ligjore për përkrahje jo-financiare OShC-ve. I vetmi dokument ku në mënyrë të tërthortë trajtohet kjo çështje është Ligji 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili edhe pse nuk i përjashton OShC-të nga shfrytëzimi i pronave komunale, nuk përcakton ndonjë procedurë apo kriter inkurajues për këtë sektor. Ky ligj është në proces të ndryshimit nga viti 2017, ndërsa angazhimi i madh i shoqërisë civile në konsultim publik mund të rezultojë në dispozita më pozitive për shoqërinë civile.

Në anën tjetër, të dhënat nga anketa me OShC tregojnë se më shumë se gjysma e OShC-ve asnjëherë nuk kanë kërkuara mbështetje jo-financiare shtetërore, ndërsa rreth 20% deklaruan se kanë marrë përkrahje jo-financiare, përqindje kjo identike me edicionin e kaluar të Indeksit. Shumica prej tyre deklaruan të kenë marrë në shfrytëzim hapësira publike pa pagesë, ndërsa vetëm disa organizata kanë marrë pajisje të ndryshme, të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të tyre, apo mjete transportuese.




Figura 48. Llojet dhe sfidat e përkrahjes jofinanciare të OShC-ve gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC

Përderisa më shumë se gjysma e organizatave të anketuara nuk kanë kërkuar përkrahje jo-financiare, kur ato e bëjnë këtë dominon kontakti i drejtpërdrejtë në raport me thirrjet e hapura. Poashtu, të dhënat nga anketa tregojnë se një numër i madh i OShC-ve nuk kanë fare informatë për mundësinë e përkrahjes jo-financiare shtetërore (18%).

## Ndikimi i perceptuar

### Reagueshmëria


Krahasuar me dy vite më parë, shoqëria civile vlerësohet të ketë reagueshmëri më të lartë ndaj brengave kryesore të qytetarëve, sidomos në fushën e zhvillimit ekonomik.

Ngjashëm si vitet e kaluara, studime të ndryshme që masin opinionin publik konfirmojnë se brengat kryesore të qytetarëve të Kosovës janë papunësia, korrupsioni, varfëria dhe cilësia e dobët e edukimit. Studimi analizon nëse shoqëria civile reagon ndaj brengave kryesore të qytetarëve, si dhe demokratizimin e vendimmarrjes në institucione, si një pjesë shumë të rëndësishme e vlerave të promovuara nga shoqëria civile në Kosovë dhe më gjerë.

Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në zhvillim ekonomik, sundim të ligjit dhe demokratizim ka ndryshuar, krahasuar me të dhënat nga edicioni i kaluar i Indeksit. Demokratizimi i vendimmarrjes në institucionet publike vlerësohet si fusha në të cilën shoqëria civile ka pasur më së shumti ndikim – 32.7% deklaruan se shoqëria civile ka pasur ndikim mesatar në këtë fushë gjatë vitit 2017, dhe rreth 7% thanë se kanë pasur ndikim të lartë. Në anën tjetër, të dhënat nga anketa me OShC tregojnë se është rritur ndikimi i sektorit të shoqërisë civile në zhvillim ekonomik të vendit krahasuar me të dhënat e vitit 2015. Më konkretisht, 22.5% e të anketuarëve mendojnë se shoqëria civile ka pasur ndikim mesatar në këtë fushë gjatë vitit 2017, deri sa 7% e tyre deklaruan se shoqëria civile ka ndikim të lartë në zhvillim ekonomik të vendit. E njëjta rritje vërehet edhe nga anketa me hisedarë të jashtëm, ku rreth gjysma e të anketuarëve deklaruan se shoqëria civile ka ndikim pozitiv në zhvillim ekonomik të vendit, 40.6% ndikim mesatar, dhe 6.9% ndikim të lartë.

Afërsisht njëjtë mbetet vlerësimi për ndikim në sundim të ligjit, ku 28.7% e OShC-ve deklaruan se shoqëria civile ka pasur ndikim mesatar, dhe 6.9% ndikim të lartë. Për dallim nga edicioni i kaluar i Indeksit, më shumë OShC deklaruan se nuk janë në gjendje për ta vlerësuar ndikimin e shoqërisë civile në këto tri fusha, respektivisht, u përgjigjen me nuk e di.

Akterët jashtë shoqërisë civile vazhdojnë të kenë mendim shumë më pozitiv për sa i përket ndikimit të shoqërisë civile në tri fushat e lartëpërmendura krahasuar me perceptimin e vet sektorit. Pjesa dërrmuese e të anketuarëve mendojnë se shoqëria civile ka pasur ndikim mesatar (47.5%) dhe ndikim të lartë (23.8%) në demokratizimin e vendimmarrjes në Kosovë.



(Figura 49: Perceptimi i OShC-ve për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore të qytetarëve – Burimi: Anketa me OShC)




Figura.50: Perceptimi i palëve të jashtme për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e brengave kryesore për qytetarët – Burimi: Anketat e Perceptimeve të Jashtme

## Ndikimi i perceptuar

Demokratizimi e arsimit vazhdojnë të mbesin fusha në të cilat shoqëria civile perceptohet të ketë ndikim më të lartë, e poashtu ku sektori është më aktiv.

Përmes angazhimit aktiv, shoqëria civile ka ndikim edhe në shumë fusha tjera, jashtë atyre të identifikuar si prioritare për qytetarët e Kosovës. Megjithatë, 2 nga 3 fushat e brengave kryesore dalin të jenë edhe fushat ku shoqëria civile në përgjithësi ka pasur ndikim më të lartë. Konkretisht, demokratizimi dhe sundimi i ligjit janë vlerësuar nga organizatat e anketuara si fushat ku shoqëria civile ka pasur më së shumti ndikim gjatë vitit 2017, të pasuara nga arsimit dhe monitorimi i institucioneve.

Demokratizimi	11%	Të drejtat e njeriut	4.2%
Sundimi i ligjit	8.3%	Zhvillimi ekonomik	2.8%
Arsimi	6.9%	Kultura, rinia dhe sporti	2.8%
Monitorimi (i punës së institucioneve)	6.9%	Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas	2.8%
Lufta kundër korrupsionit	5.6%	Kultura, rinia dhe sporti	2.8%
Hartim dhe zbatim të politikave dhe legjislacionit	5.6%	Mbrojtja e mjedisit	1.4%
Bujqësia	4.2%	Në asnjë fushë	20.8%

(Figura 51: Perceptimi i OShC-ve për fushat kryesore të ndikimit të shoqërisë civile në përgjithësi – Burimi: Anketa me OShC)



Ndërkaq, të pyetur se në cilën fushë ka pasur më së shumti ndikim organizata e tyre, 11% e organizatave të anketuara u deklaruan në arsim, 6% në zhvillim të kapaciteteve të shoqërisë civile, dhe 5% në zhvillim ekonomik. Përderisa arsimi dhe demokratizimi qëndrojnë lart si në ndikimin e perceptuar të sektorit në përgjithësi ashtu edhe të organizatave të anketuara individualisht, kultura është mjaft e shprehur te ndikimi i perceptuar i organizatave por dukshëm më poshtë te sektori në përgjithësi.

Niveli i aktivitetit, si kategori mbetet subjektive, është matur përmes perceptimit të hisedarëve të jashtëm, gjegjësisht duke i pyetur ata se cilat ishin fushat ku mendojnë se shoqëria civile ka qenë më aktive gjatë vitit 2017. Kjo anketë tregon se fushat në të cilat shoqëria civile në Kosovë ka treguar më shumë aktivitet janë arsimi, sundimi i ligjit, dhe mbrojtja e mjedisit. Ngjashëm me edicionet e kaluara, këto rezultate konfirmojnë që shoqëria civile mund të jetë aktive në një fushë, por jo patjetër të ketë ndikim.

## Avokimi

Një pjesë e konsiderueshme e punës së OShC-ve është e orientuar drejt avokimit, qoftë përmes komunikimit me institucione publike, pjesëmarrjes në hartim të politikave, apo protestës – të gjitha këto në funksion të përmbushjes së një kërkesë legjitime apo nevoje qytetare. Avokimi për kauza dhe çështje të caktuara kërkon një numër parakushtesh. Në këtë pjesë trajtohet i tërë cikli, duke filluar nga komunikimi me institucionet relevante publike, qasja në informata deri te përfshirja e drejtpërdrejtë në hartimin e politikave.




Figura 52, Komunikimi i OShC-ve me institucionet publike të cilat veprojnë në fushën e njejtë me atë të organizatës së tyre – Burimi: Anketa me OShC

Të dhënat nga anketa me OShC tregojnë për një komunikim më të rrallë të OShC-ve me institucionet publike, krahasuar me të dhënat e vitit 2015. Rreth një e treta e OShC-ve të anketuara deklaruan se komunikojnë shpesh me institucionet publike të cilat veprojnë në fushën e njejtë me atë të organizatës së tyre (32.7%), dhe vetëm 7.9% thanë se komunikojnë rregullisht me këto institucione. Një analizë më e detajuar e të dhënave tregon se OShC-të veprimtaria e të cilave shtrihet në tërë Kosovën komunikojnë më shpesh me institucionet publike krahasuar me OShC-të tjera. Ndërkaq, të dhënat tregojnë se të hyrat e organizatës nuk kanë ndonjë ndikim në këtë drejtim.

Ngjashëm sikurse në edicionin e kaluar të Indeksit, komunikimi i OShC-ve me institucionet të cilat kanë mandat bashkëpunimin dhe komunikimin me OShC mbetet i ulët. Më konkretisht, 9% e OShC-ve komunikojnë shpesh me Zyrën për Qeverisje të mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe 22% tjera komunikojnë vetëm kohë pas kohe. Afërsisht njejtë qëndron edhe Zyra për Kordinim të Donatorëve dhe Marrëdhënie me Shoqërinë Civile e Kuvendit të Kosovës. Në anën tjetër, OShC-të komunikojnë pak më shumë me DOJQ, dhe atë kryesisht për shkak që ky departament ka për mandat regjistrimin e OShC-ve dhe është adresa e parë e kontaktit për të gjitha çështjet administrative të OShC-ve.





Figura 53. Komunikimi i OShC -ve me institucionet publike përgjegjëse për bashkëpunim me shoqërinë civile – Burimi: Anketa me OShC)



- Po, jemi angazhuar rregullisht
- Po, nganjëherë angazhohemi në zbatimin e tij
- Jo, nuk jemi angazhuar në zbatimin e tij
- Jo, në Kosovë nuk ka dokument të tillë strategjik të bashkëpunimit
- Nuk kemi njohuri mbi atë lloj dokumenti
- Nuk e di

(Figura 54.: Përfshirja e OShC-ve në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile – Burimi: Anketa me OShC)


Duke qenë dokumenti kryesor që e përcakton politikën qeveritare ndaj sektorit, anketa ka matur edhe nivelin e përfshirjes dhe njohurive të shoqërisë civile në zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Ngjashëm me edicionin e kaluar, përqindjet e atyre që janë përfshirë ose kanë njohuri për dokumentin janë mjaft të ulëta. Gati gjysma e OShC-ve të anketuara nuk kanë fare njohuri për këtë dokument (45%), deri sa një e treta e tyre deklaruan se përkundër që kanë njohuri, nuk janë angazhuar asnjëherë në zbatimin e këtij dokumenti (28.7%). Rreth 19% e OShC-ve thanë të jenë angazhuar në zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.

## Qasja në informata

Krahasuar me dy vite më parë ka një përmirësim të lehtë të qasjes së shoqërisë civile në informata publike, edhe pse informimi nga institucionet publike ende mbetet i pamjaftueshëm.

Qasja në informata është parakusht për çfarëdo angazhimi të shoqërisë civile në jetën publike në përgjithësi, dhe në veçanti për pjesëmarrje në hartim të politikave. Qasja në informata publike është e drejtë kushtetuese, e garantuar në nenin 41 të Kushtetutës, ndërkaq Ligji 03/L-215 për qasjen në dokumente publike përkufizon parimet dhe kushtet për qasje në dokumente publike. Ky ligj dhe akte tjera nënligjore përcaktojnë informata e dokumente që duhet të jenë publike pa pasur nevojë që të bëhet ndonjë kërkesë, ndërsa kur ka nevojë që të kërkohet qasje, institucionet publike obligohen t'i kthejnë përgjigje palës brenda 7 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

Në përgjithësi, pak OShC deklarojnë se janë mjaftueshëm të informuar nga institucionet publike për fushat në të cilat këto OShC angazhohen. Kështu, shumica dërrmuese e OShC-ve të anketuara deklaruan se janë pak të informuara nga institucionet publike për fushat në të cilat veprojnë (44%) ose aspak (29%). Vetëm rreth 25% e të anektuarëve deklaruan se janë të informuar mjaftueshëm nga institucionet publike lidhur me punën e tyre në fushën e OShC-ve.



**Figura 55. Informimi i OShC-ve nga institucionet publike për punën e tyre në fushën e veprimit të organizatës gjatë vitit 2017 – Burimi: Anketa me OShC**

Në anën tjetër, është i ulët edhe numri i organizatave që kanë kërkuar qasje në dokumente publike. Në mesin e OShC-ve të anketuara, vetëm rreth 19% e tyre deklaruan se kanë bërë kërkesë për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2017. Megjithatë, kur OShC-të bëjnë kërkesë për qasje në dokumente publike, duket se në masë të madhe përgjigjet i marrin me vonesë (42%), apo nuk marrin përgjigje fare, respektivisht refuzohen përmes heshtjes administrative (21%).

## Pjesëmarrja në politikëbërje

Krahasuar me situatën e para dy viteve, pjesëmarrja e shoqërisë civile në politikëbërje gjatë vitit 2017 ka pësuar rënie. Zgjedhjet në të dyja nivelet dhe rënia e dinamikës së politikëbërjes gjatë vitit 2017 duket se kanë ndikuar në rënien e dukshme të përqindjes së organizatave që kanë qenë aktive në proces të politikëbërjes dhe atyre që kanë pranuar ftesa të rregullta për konsultim publik.

Korniza ligjore në Kosovë parasheh përfshirjen e OShC-ve dhe të qytetarëve në vendimarrje në të gjitha nivelet e qeverisjes, me përjashtim të Kuvendit të Kosovës, ku përfshirja e OShC-ve është jo obligative. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara në Kushtetutë, Rregullorja e Punës e Qeverisë parasheh konsultimet publike për të gjitha propozimet e politikave dhe ligjeve, ku organi propozues duhet të jep informacionin e duhur dhe me kohë, si dhe informatat për rezultatet e konsultimit. Në Rregulloren e Punës të Kuvendit parashihet mundësia që të ftohen OShC-të në takimet e Komisioneve Parlamentare dhe të organizohen dëgjime publike. Ligji për vet-qeverisje lokale përmban mekanizma të pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal, duke përfshirë konsultimet publike, komisionet sektoriale konsultative, petitionet, takimet publike me kryetarin e komunës, etj. Gjithashtu, nga janari 2017 është në fuqi edhe Rregullorja për standarde minimale për procesin e konsultimit publik në nivel të qeverisë, e cila ka filluar së zbatuari por ende jo në nivelin e duhur.

Të dhënat nga anketa me OShC tregojnë se një numër i madh i organizatave nuk e përcjellin fare procesin e hartimit të ligjeve dhe politikave në Kosovë. Në mesin e atyre që janë aktive në këtë fushë, shumica deklaruan se rregulloret, draft ligjet, ose draftet e politikave asnjëherë nuk publikohen në kohë (24%), ose rrallë herë publikohen në kohë 38%. Në anën tjetër, një numër tejet i vogël i organizatave deklaruan se janë ftuar rregullisht për konsultim publik, sa herë që ka pasur çështje që ndërlidhen me punën e tyre (5%), ose që janë ftuar vetëm kohë pas kohe (21.8%), derisa më shumë se gjysma e tyre deklaruan se nuk janë ftuar asnjëherë në ndonjë konsultim publik nga autoritetet publike gjatë viti 2017. Ngjashëm u përgjigjen organizatat edhe kur u pyetën nëse organizata e tyre është angazhuar në hartimin e ndonjë politike publike, ligji, apo rregulloreje komunale, ku vetëm rreth 18% e tyre deklaruan të jenë angazhuar në hartim të ndonjë politike publike gjatë vitit 2017. Sikur se tek edicioni i kaluar i Indeksit, të dhënat tregojnë se OShC-të të cilat me punën e tyre kanë shtrirje më të gjerë gjeografike, marrin ftesë më shumë për konsultim publik krahasuar me OShC-të veprimtarja e të cilave është e kufizuar në një fshat, qytetet apo institucion të pavarur.

Përderisa efektet e plota të hyrjes në fuqi të Rregullores për standarde minimale për konsultim publik mbetet të analizohen më tej, duket që kjo rënie e dukshme e pjesëmarrjes kryesisht vjen për shkak që viti 2017 ka qenë vit zgjedhor, në të dyja nivelet. Konkretisht, zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2017 kanë ndikuar në rënien e dinamikës së punës së Qeverisë dhe Kuvendit disa muaj më herët, ndërsa procesi i politikëbërjes gati se është ndalur plotësisht nga qershori deri në formimin e qeverisë në shtator 2017. Ngjashëm, zgjedhjet lokale të tetorit 2017 kanë bërë që edhe pjesa e dytë e vitit të karakterizohet me përqendrim në fushatë zgjedhore, e jo në procese zyrtare të hartimit të politikave publike e akteve normative.

Të pyetur rreth përvojës së tyre gjatë procesit të konsultimit publik, rreth 41% e OShC-ve deklaruan se nuk u janë ofruar informata të mjaftueshme rreth përmbajtjes së dokumenteve për konsultim, dhe vetëm 14% deklaruan se kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur ftesës për konsultim publik. Poashtu, një numër shumë i vogël deklaruan se janë konsultuar në fazën fillestare të procesit të hartimit të politikës apo legjislacionit. Në anën tjetër, vetëm një e katërta e të anketuarëve mendojnë se personat përgjegjës për udhëheqje të konsultimit publik nga radhët e institucionit publik kanë qenë kompetent për punën e tyre dhe se OShC-ve i'u kanë ofruar këshilla dhe informata të mjaftueshme (25%).




Figura 56, Përvoja e OShC-ve gjatë procesit të konsultimit publik – Burimi: Anketa me OShC

Ajo që përsëritet nga edicioni në edicion, dhe vazhdon të mbetet shqetësuese është niveli i ulët i informatave kthyes nga konsultimi publik. Rreth 73.3% e OShC-ve deklaruan se asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë përgjigje me shkrim rreth arsyeve të refuzimit të komenteve të tyre. Në anën tjetër, të dhënat tregojnë se organizatat të cilat kanë pranuar arsyetim për komentet e tyre të refuzuara veprojnë në nivel komunal. Kjo e gjetur konfirmon konstatimet e bëra në Indeksin 2015, deri sa jep indikacion se niveli lokal i qeverisjes i zbaton mekanizmat e komunikimit, respektivisht arsyetimit më mirë krahasuar me nivelin qendror.




Figura 57, Pranimi i shpjegimit në rast të refuzimit të komenteve të OShC-ve gjatë procesit të konsultimit – Burimi: Anketa me OShC

Në përgjithësi, vërehet se vetëm një pjesë e organizatave të shoqërisë civile janë aktive në procesin e hartimit të politikave, ndërsa, pjesa dërrmuese deklaruan se nuk ftohen fare për konsultim publik nga autoritetet publike (61.4%), nga të cilët, rreth gjysma nuk e përcjellin fare procesin e hartimit të ligjeve dhe politikave. Megjithatë, organizatat të cilat marrin pjesë në proceset e politik-bërjes duket se janë më të konsoliduara. Në mesin e organizatave që deklaruan se janë aktive në procesin e hartimit të politikave, shumica dërrmuese e tyre thanë se këtë angazhim do ta bënin pavarësisht nëse organizata e tyre posedon fonde për një gjë të tillë ose jo. Poashtu, kur OShC-të marrin pjesë në procese të konsultimit publik për hartim të ligjeve ose politikave, në masë të madhe ato merren parasysh prej institucioneve publike. Shumica dërrmuese e OShC-ve që kanë marrë pjesë në ndonjë proces të konsultimit publik gjatë vitit 2017 deklaruan se komentet e tyre janë pranuar pjesërisht (64%) apo plotësisht (12.8%).




Figura 58, Pranimi i komenteve të OShC-ve gjatë procesit të konsultimit publik – Burimi: Anketa me OShC

Në anën tjetër, vazhdon të mbetet e ulët pjesëmarrja e OShC-ve në grupe të ndryshme punuese apo organe tjera të themeluara nga institucionet publike. Shumica dërrmuese e OShC-ve deklaruan se nuk janë ftuar asnjëherë për të marrë pjesë në ndonjë trupë të përbashkët me institucionet publike, qoftë grup punues, organ konsultativ apo tjera të ngjashme (95%). Ato pak organizata që janë ftuar, kryesisht janë ftuar nga Kuvendi i Kosovës dhe komunat. Në shumicën e rasteve, përfaqësuesit e shoqërisë civile janë emëruar drejt-përdrejtë nga institucionet publike, ndërsa nga të gjitha organizatat e anketuara, vetëm një rast është raportuar ku i është kërkuar vet organizatave që të emërojnë përfaqësuesin e tyre në grupin punues përkatës.

# Ambienti i Jashtëm

## Konteksti socio-ekonomik

Duke u bazuar në të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë, të kryer nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Kosova në vitin 2011 kishte 1,739,825 banorë, ku 50.3% prej tyre ishin burra dhe 49.7% gra; rreth 63% e popullsisë ishin nën moshën 34 vjeçare, duke e bërë Kosovën kështu vendin me popullatën më të re në Europë<sup>11</sup>. Vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës janë që në fund të vitit 2017, Kosova kishte 1.798.506 banorë<sup>12</sup>.

Gjatë vitit 2017, Vlera e Bruto Produktit Vendor (BPV) vlerësohet të ketë qenë 6.3 miliardë EUR<sup>13</sup>, ndërsa në vitin 2016 BPV për kokë banori ishte 3,386 euro,<sup>14</sup> duke i bërë të ardhurat mesatare rreth dhjetë herë më të ulëta sesa ato në nivel të BE-së. Përkundër faktit të rritjes pozitive ekonomike ndër vite, Kosova mbetet ende një nga vendet më të varfra të Europës. Gjatë vitit 2017 Kosova shënoi rritje ekonomike prej 4.4%, gjë që e cilësoi si vendin me rritjen ekonomike më të dukshme në rajon, por kjo rritje ende mbetet shumë e vogël për t'i sjellë zhvillim të shprehur ekonomik vendit<sup>15</sup>. Pa marrë parasysh këtë rritje ekonomike, një pjesë e madhe e popullsisë (50.01%) mbeten të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me drejtimin aktual ekonomik të Kosovës, 38% janë neutral, ndërsa vetëm 11.9% janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të vendit<sup>16</sup>. Varfëria mbetet e lartë, pa varësisht kriterëve mbi vijat e standardizuara të varfërisë që mund të përdoren. Të dhënat e fundit të ASK-së nga viti 2015 tregojnë që shkalla e varfërisë në Kosovë është 17.6% (me kufirin e varfërisë të caktuar në 1.82 EUR në ditë), ndërsa ajo e varfërisë së skajshme është 5.2% (me kufirin e varfërisë së skajshme të caktuar në 1.30 EUR në ditë)<sup>17</sup>. Papunësia në shkallë të lartë dhe mungesa e vendeve cilësore të punës i kanë kontribuar varfërisë dhe pasigurisë së të ardhurave. Kosova ka një prej shifrave më të ulëta të punësimit në Europë. Në vitin 2017, vetëm 29.8% të popullsisë së Kosovës në moshë pune ishin të punësuar, ndërsa 30.5% prej tyre ishin të papunë<sup>18</sup>. Shkalla e pasivitetit të fuqisë punëtore është edhe më brengosëse, ku gjatë vitit 2017 përqindja e popullsisë që nuk ishin ekonomikisht aktiv shënonte 57.2%. Të gjithë indikatorët e punësimit tregojnë që gratë dhe të rinjtë janë më të prekurit nga papunësia ose joaktiviteti ekonomik: vetëm 20% të grave në moshë pune janë aktive në tregun e punës krahasuar me 65.3% të burrave; vetëm 12.7% të grave në moshë pune janë të punësuar në raport me 46.6% të burrave; 52.7% të personave të moshës 15-24 vjeçare ishin të papunë.

<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Regjistrimi i popullsisë 2011: Të gjeturat kryesore (Prishtinë, 2012). Mund të gjendet në: [http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata\\_\\_09%20Population\\_\\_Population%20Structure/ps02.px/table/tableViewLayout1/?rxid=6e365ede-2905-445c-87f6-12f3ce368482](http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__09%20Population__Population%20Structure/ps02.px/table/tableViewLayout1/?rxid=6e365ede-2905-445c-87f6-12f3ce368482)

<sup>12</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës (Prishtinë, 2018). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/4149/vjetari-statistikor-2018-final.pdf>

<sup>13</sup> Banka Qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2017 (Prishtinë, 2018) Mund të gjendet në: [https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK\\_RV\\_2017.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf)

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Bruto Produkti Vendor 2008-2016 (Prishtinë, 2017). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/3628/bpv-2008-2016.pdf>

<sup>15</sup> World Bank Country Snapshot April 2018

<sup>16</sup> Puls Publik XIV

<sup>17</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës 2012-2015 (Prishtinë, 2017). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

<sup>18</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore 2017 (Prishtinë, 2018). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/3972/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-2017-1.pdf>



Dërgesat monetare nga jashtë apo remitancat vazhdojnë të kenë ndikim të lartë në zhvillimin ekonomik, së bashku me shpenzimet qeveritare dhe rritjen e aktivitetit kredidhënës.<sup>19</sup> Megjithatë, vazhdon të mos ketë ndonjë rritje thelbësore të kërkesës për fuqi punëtore e cila do të zvogëlonte presionin prej rreth 20,000 të ardhurve të ri, të cilët çdo vit hyjnë në tregun e punës. Sipas të dhënave të fundit për vitin 2016 nga ASK, sektori privat dominohet nga ndërmarrjet tregtare (47.7% të ndërmarrjeve me 34.9% të të punësuarëve), ndërsa ato në kategorinë e prodhimit përbëjnë vetëm 13.5% të ndërmarrjeve, respektivisht 15.6% të të punësuarëve.<sup>20</sup> Ngjashëm, nga 9,223 ndërmarrje të reja të regjistruara gjatë vitit 2017, 26.6% janë të koncentruara në sektorin e tregtisë, të pasuara me 10.1% në sektorin e hotelierisë dhe rreth 9.5% në sektorët e prodhimit, respektivisht bujqësisë. Rreth 99% prej tyre janë mikro-ndërmarrje, me më pak se 10 të punësuar.<sup>21</sup> Kjo strukturë e ndërmarrjeve nuk ka potencial për krijim domethënës të vendeve të punës. Remitancat, që konsiderohen si kategoria më e madhe në kuadër të llogarive dytësore, gjatë vitit 2017 arritën në vlerë prej 759.2 milionë EUR duke u shënuar rritje prej 9.9% nga viti i kaluar.<sup>22</sup> Vendet nga të cilat vijnë më së shumti remitanca janë Gjermania me 39.3% të tyre, Zvicra me 22.5% dhe ShBA-të me 7.0%.<sup>23</sup> Deficiti tregtar mbetet i madh; eksporteve që kanë arritur shumë prej afër 378.0 milionë EUR në vitin 2017, u kundërvihet importi që arriti shifrën prej 3.047 miliardë EUR.<sup>24</sup> Përveç kësaj, të punësuarit mbesin të cenueshëm për shkak të informalitetit të madh në ekonomi. Studimet e fundit të para disa viteve flasin për madhësinë e sektorit joformal në Kosovë që shkon nga 34% deri në 37%, varësisht nëse matet përmes numrit të ndërmarrjeve që u ikin pagesës së tatimit apo numrit të ndërmarrjeve që nuk raportojnë të punësuarit e tyre tek institucionet përkatëse të shtetit.<sup>25</sup> Një shkallë e ngjashme vërtetohet gjithashtu edhe nga deklaratimet e Ministrit të Financave në fund të vitit 2017.<sup>26</sup>

Diaspora e madhe e Kosovës është rezultat i lëvizjeve tradicionale të qytetarëve të Kosovës në Europën Perëndimore dhe përtej për shkak të rrethanave të ndryshme politike dhe ekonomike. Në krahasim me valët e mëdha të emigrimit që e kapluan Kosovën gjatë viteve 2014 dhe 2015, gjatë dy viteve të fundit numri i azilkërkuësve nga Kosova në vendet e perëndimit ka rënë dukshëm. Kështu, numri i azilkërkuësve nga Kosova në vendet e BE-së dhe të Zonës Schengen ka rënë nga 73,235 sa ishin gjatë vitit 2015 në 11,965 gjatë vitit 2016, dhe në rreth 7,575 gjatë vitit 2017.<sup>27</sup> Ngjashëm numrat e kosovarëve të kthyer kanë rënë nga 18,789 sa ishin në 2015 në 11,030 në 2016 dhe 4,509 në 2017.<sup>28</sup>

<sup>19</sup> Banka Qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2017 (Prishtinë, 2018) Mund të gjendet në: [https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK\\_RV\\_2017.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf)

<sup>20</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës (Prishtinë, 2018). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/4149/vjetari-statistikor-2018-final.pdf>

<sup>21</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, Republika e Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës (Prishtinë, 2018). Mund të gjendet në: <http://ask.rks-gov.net/media/4149/vjetari-statistikor-2018-final.pdf>

<sup>22</sup> [https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK\\_RV\\_2017.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf)

<sup>23</sup> [https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK\\_RV\\_2017.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK_RV_2017.pdf)

<sup>24</sup> <http://ask.rks-gov.net/media/4085/tregtija-e-jashtme-2017-shqip.pdf>

<sup>25</sup> Zeka, Elda, Prenton Hyseni, Julia Leuther, Gent Beqiri, Lumir Abdixhiku, Alban Hashani dhe Agon Nixha. To Pay or Not to Pay: A Business Perspective of Informality in Kosovo. Report. Riinvest. Prishtina: Riinvest, 2013. Mund të gjendet në: [http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2013/BUSINESS\\_INFORMALITY\\_\\_ENG\\_FINAL.pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2013/BUSINESS_INFORMALITY__ENG_FINAL.pdf)

<sup>26</sup> "31.7% e ekonomisë në Kosovë është jo formale." Nëntor 2017. Telegrafi. Qasur më 15 gusht 2018. <https://telegrafi.com/31-7-e-ekonomise-ne-kosoves-eshte-jo-formale/>

<sup>27</sup> Komisioni Europian, Raporti për Kosovë 2018 (Bruksel, 2018). Mund të gjendet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

<sup>28</sup> Komisioni Europian, Raporti për Kosovë 2018 (Bruksel, 2018). Mund të gjendet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

## Konteksti socio-politik

Gjatë viteve të fundit, peizazhi politik i Kosovës ka përjetuar disa zhvillime karakteristike. Edhe pse kanë kaluar 6 vite që nga fundi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës nga një entitet i huaj, Kosova ende mbetet nikoqire dhe subjekt i organizatave politike, gjyqësore dhe ushtarake të huaja, siç janë NATO dhe EULEX. Të dyja këto organizata vazhdojnë të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm politik brenda Kosovës, edhe pse nga qershori 2018 EULEX ka ndryshuar mandatin e tij duke i larguar shumicën e kompetencave ekzekutive dhe duke u fokusuar në mandatin mbështetës, monitorues dhe këshillues për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë.<sup>29</sup> Po ashtu, Kosova mbetet e sfiduar në arenën ndërkombëtare, pasi që pesë shtete anëtare të BE-së dhe një numër domethënës i shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) vazhdojnë të mos e njohin pavarësinë e saj.<sup>30</sup> Duke e siguruar njohjen e Barbados gjatë vitit 2018, numri i shteteve që e kanë njohur Kosovën deri më sot ka arritur në 118,<sup>31</sup> numër ky vetëm për 7 shtete më i lartë se i gushtit të vitit 2016.

Kosova gjatë dy viteve të fundit ka vazhduar të shënojë një përmirësim të lehtë në vlerësimin demokratik që Freedom House e bënë në bazë vjetore, duke u konsideruar si regjim gjysmë i konsoliduar autoritar me një notë prej 4.93<sup>32</sup>. Viti 2017 shënoi një vit të ngjeshur sa i përket aktiviteteve zgjedhore, pasi për një periudhë shumë të shkurtë kohore Kosova mbajti zgjedhje në nivel qendror dhe lokal. Me pretekst të pamundësisë së shtyrjes përpara të disa proceseve të rëndësishme politike, specifikuat të ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, Qeveria e atëhershme e drejtuar nga Isa Mustafa u rrëzua në maj të vitit 2017. Zgjedhjet e parakohshme u shpallën nga Presidenti në afatin më të shkurtë kohor për 11 qershor 2017. Këto zgjedhje në përgjithësi u cilësuan si të qeta dhe demokratike por me disa pengesa të përsëritura si, listat e pasakta të votuesëve, afat i shkurtë i paarsyeshëm për zgjedhje të hershme, sistem jo funksional për të votuar jashtë vendit<sup>33</sup>. Edhe pas këtyre zgjedhjeve, vendi hyri në një periudhë të ngërçit politik të shkaktuar nga pamundësia e subjekteve politike për tu marrë vesh rreth pozitës së Kryeparlamentarit dhe pamjaftueshmërisë së votave për të themeluar Qeverinë. Bllokada institucionale 3 mujore u ndërpre vetëm kur një parti e vogël parlamentare kaloi në anën tjetër, duke e siguruar shumicën e nevojshme për ta formuar Qeverinë e re me Ramush Haradinaj si kryeministër.<sup>34</sup> Përveç ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi në mars të vitit 2018, ky koalicion është vlerësuar që nuk ka pasur shumë sukses për të shtyrë përpara reformat e lidhura me integrimin në Bashkimin Europian si dhe për të siguruar konsensus më të gjerë për çështjet kyçe që e preokupojnë Kosovën<sup>35</sup>.

<sup>29</sup> "Mandati i ri i EULEX-it", 8 qershor 2018. Misioni Eulex. Qasur më 15 gusht 2018 <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,10,836>

<sup>30</sup> "Sa do të zgjasë tërheqja e njohjes së Kosovës nga Liberia", 20 qershor 2018. Koha Ditore. Qasur më 15 gusht 2018 <https://www.koha.net/arberi/100439/sa-do-te-zgjase-terheqja-e-njohjes-se-kosoves-nga-liberia/>

<sup>31</sup> Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës <http://www.mfa-ks.net/?page=1,259>

<sup>32</sup> Freedom House, Freedom in the World 2018 <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/freedom-world-2018>

<sup>33</sup> Misioni Monitorues i Zgjedhjeve i BE-së, Raporti për Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2017. Mund të gjendet në: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final\\_report\\_eom\\_kosovo\\_june\\_2017.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_eom_kosovo_june_2017.pdf)

<sup>34</sup> "Ramush Haradinaj zgjidhet Kryeministër i ri i Kosovës", 9 shtator 2017. RTK. Qasur më 15 gusht 2018 <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=197510>

<sup>35</sup> Raporti i progresit

Dialogu politik për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë që filloi në vitin 2012 është duke vazhduar, edhe pse me një ritëm të paparashikueshëm dhe me probleme të theksuara të legjitimitetit mbi atë se kush duhet ta udhëheqë dialogun në emër të Kosovës<sup>36</sup>. Përderisa ka probleme në zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, një ndër marrëveshjet më të rëndësishme të dala nga ky proces gjatë këtyre dy viteve ishte ajo e drejtësisë, përmes së cilës gjatë tetorit të vitit 2017 u dekretuan 40 gjykatës dhe 13 prokurorë serbë, duke e përfunduar kështu procesin e rekrutimit të personelit të gjyqësorit në veri.<sup>37</sup>

Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA) në prill të vitit 2016, institucionet kanë vazhduar me krijimin e mekanizmave të zbatimit, si dhe prioritizimin e reformave nëpërmjet Agjendës së Reformës Europiane (ERA). Kjo Agjendë ka identifikuar si fusha prioritare të reformimit qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, konkurueshmërinë dhe klimën e investimit, punësimit dhe arsimit.<sup>38</sup> Në përgjithësi, zbatimi i masave të parapara me MSA është në nivel të ulët<sup>39</sup>, ndërsa disa nga arsyet kryesore për këtë vlerësohet të jenë mungesa e koordinimit në mes të institucioneve zbatuese, mungesa e buxhetit të dedikuar për zbatim dhe moskuptimi i duhur i rëndësisë së MSA-së dhe procesit të integritit evropian nga disa institucione.<sup>40</sup>

Duke qenë se partitë politike janë palët politike me ndikimin më të madh, financimi i tyre mbetet çështja më problematike. Partitë kryesore politike kryesisht financohen nga bizneset private, ndërsa raportet e shpenzimeve të tyre nuk janë publikuar, edhe pse ekzistojnë disa ligje ku parashihet që partitë politike ta bëjnë një gjë të tillë.<sup>41</sup> Problemi kryesor mbetet paqartësia e pasqyrave financiare të subjekteve politike, një problem që vetëm se është përkeqësuar me ndryshimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike. Ndryshimi kryesor ka të bëjë me kalimin e kompetencave të përzgjedhjes së auditorëve për auditimin e pasqyrave financiare të partive nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek Kuvendi i Kosovës, gjë që ka ndikuar të mos ketë auditim të pasqyrave që nga viti 2013.<sup>42</sup> Ngjashëm me të kaluarën, edhe gjatë vitit zgjedhor 2017 shumë parti politike rekrutuan aktivistë të shoqërisë civile apo mediave vetëm pak kohë para zgjedhjeve, por efekti i këtyre rekrutimeve në demokratizim të brendshëm ishte i papërfillshëm.

<sup>36</sup> "Kosovë: Thaçi kërkon krijimin e grupit të unitetit për dialog me Serbinë", 2 korrik 2018. Deutsche Welle. Qasur më 15 gusht 2018 <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-tha%C3%A7i-k%C3%ABrkon-krijimin-e-grupit-t%C3%AB-unitetit-p%C3%AB-dialog-me-serbin%C3%AB/a-44487918>

<sup>37</sup> Raporti I progresit

<sup>38</sup> Raporti I progresit

<sup>39</sup> "Ministrja Hoxha kërkon më shumë punë nga institucionet për zbatimin e MSA-së", 7 gusht 2018. Ministria e Integritit Europian. Qasur më 15 gusht 2018 <http://mei-ks.net/sq/lajmet/ministrja-hoxha-krkon-m-shum-pun-nga-institucionet-pr-zbatimin-e-msa-s>


<sup>40</sup> "Monitorimi i zbatimit të MSA-së...", 5 maj 2018. Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Qasur më 15 gusht 2018 <http://www.informatat.com/glps-per-gjashtemujorin-e-dyte-te-2017-tes-u-realizuan-39-te-objektivave-per-msa-ne/>

<sup>41</sup> Visar Sutaj dhe Artan Canhasi. National Integrity System Assessment Kosovo. Report. Kosovo Democratic Institute. KDI, 2015. Mund të gjendet në: [http://www.kdi-kosova.org/publikime/19-2015-10-31-kdi-tik-nis-eng\\_all\\_single\\_final-3.pdf](http://www.kdi-kosova.org/publikime/19-2015-10-31-kdi-tik-nis-eng_all_single_final-3.pdf)

<sup>42</sup> <http://kosovotwopointzero.com/political-party-funding-kosovo/>

## Konteksti socio-kulturor

Krahasuar me vitet 2015 dhe 2016, ku kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin e vendit shënonte vlerësim të ulët, në fund të vitit 2017 dhe fillim të vitit 2018 ky parametër ka shënuar rritje. Megjithatë, vlerat mbesin të ulëta në përgjithësi: vetëm 15.2% të qytetarëve shprehën të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, ndërsa 50.5% të pakënaqur ose shumë të pakënaqur. Trend i ngjashëm është edhe te kënaqshmëria me punën e institucioneve kyçe të vendit. Rezultatet e prillit 2018 tregojnë që vetëm 30% të qytetarëve të anketuar janë të kënaqur me punën e Qeverisë, 33% me punën e Kuvendit, 31.2% me punën e Gjykatave dhe 29.9% me Zyrën e Prokurorit. Nga pozitat kryesore, kënaqshmëria e qytetarëve sillet prej 39.1% me punën e Presidentit, 33.2% me punën e Kryeministrit dhe 31.5% me punën e Kryetarit të Kuvendit.<sup>43</sup>



(Figura.59: Trendët e mendimeve të qytetarëve për drejtimin politik, proceset demokratike dhe gatishmërinë për protestën – Burimi: Puls i publik XIV i UNDP-së)


Në anën tjetër, përqindja e qytetarëve të gatshëm për të protestuar për arsye politike mbetet e ngjashme sikurse para dy vitesh, në vlerat prej pak më pak se 40%. Edhe pse mbetet i ulët, Indeksi i Demokratizimit i matur nga Puls i Publik i UNDP-së është rritur gjatë dy viteve të fundit, me disa elemente që kanë ndikuar në këtë rritje, siç janë vlerësimi që Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës janë demokratike, se media në Kosovë gëzon lirinë e shprehjes, dhe se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, mbetet mjaft shqetësues besimi i ulët i qytetarëve në ndryshim nëpërmjet zgjedhjeve, ku vetëm 32% të votuesëve potencial mendojnë që vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.<sup>44</sup>

Gjatë dy viteve të fundit ka pasur më pak matje të opinionit publik rreth besueshmërisë në institucioneve. Megjithatë, të dhënat në dispozicion tregojnë që institucionet e sigurisë vazhdojnë të mbeten më të besuarat, me FSK-në në krye të listës me 78% të qytetarëve që i besojnë këtij institucioni, pasuar nga KFOR me 66% dhe Policia e Kosovës me 61%.

<sup>43</sup> UNDP Zyra në Kosovë, Puls i Publik XIV (Prishtinë, 2018). [http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/public-pulse-xiv.html](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiv.html)

<sup>44</sup> UNDP Zyra në Kosovë, Puls i Publik XIV (Prishtinë, 2018). [http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/public-pulse-xiv.html](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiv.html)

Në ekstremin tjetër qëndrojnë Qeveria dhe Kuvendi, të cilëve u besojnë 14%, respektivisht 12% të qytetarëve. Komunat (37%), Prokuroria (29%) dhe Gjykatat (25%) mbesin gjithashtu me besueshmëri të ulët.<sup>45</sup>



(Fig.60: Niveli i besimit të qytetarëve në shoqëri civile – Burimi: Pulsi Publik XIV i UNDP-së)

Shoqëria civile vazhdon të mbetet në listën e sektorëve më të besuar, përkundër një rënie të vogël krahasuar me vitin 2015. Ngjashëm me të dhënat e viteve të kaluara, më shumë se gjysma e qytetarëve mendojnë që shoqërisë civile mund t'i besohet.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është e garantuar me kornizë ligjore kryesisht sipas standardeve europiane, mirëpo zbatimi në praktikë është i mangët për shkak të mungesës së buxhetit dhe burimeve tjera, mungesës së prioritizimit politik dhe kordinimit të munguar. Të drejtat e pakicave, mungesa e barazisë gjinore dhe mungesa e sistemit për mbrojtje të fëmijëve mbesin problemet kryesore.<sup>46</sup> Liria e shprehjes dhe liria e medieve gjatë këtyre viteve janë çenuar, sidomos sa i përket numrit të shtuar të kërcënimeve dhe sulmeve të raportuara ndaj gazetarëve. Gjatë vitit 2017 p.sh. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka raportuar 24 incidente, pothuajse dyfish nga viti paraprak. Mbetet shqetësues reagimi i vakët i sistemit të drejtësisë në hetimin dhe dënimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes në përgjithësi. Në listën e këtyre incidenteve janë të përfshirë dy raste kërcërimi me vdekje ndaj dy kryeredaktorëve dhe një rast i kërcënimit të një gazetari të sulmuar nga një deputet i kuvendit.<sup>47</sup> Raporti i Komisionit Europian për Kosovë gjithashtu kritikon mënyrën e financimit shtetëror të Radio-Televizionit të Kosovës që vazhdon ta rrezikojë pavarësinë e këtij institucioni, duke e bërë atë më të ndjeshëm ndaj presioneve politike.

<sup>45</sup> Barometri Kosovari i Sigurisë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), 2018. Mund të gjendet në: <http://www.qkss.org/sq/Raportet/Barometri-Kosovar-i-Sigurise-Edicioni-i-Shtate-1050>

<sup>46</sup> Komisioni Europian, Raporti për Kosovë 2018 (Bruksel, 2018). Mund të gjendet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

<sup>47</sup> Komisioni Europian, Raporti për Kosovë 2018 (Bruksel, 2018). Mund të gjendet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>




Figura 61. Niveli i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve-Burimi: Pulsi Publik XIV i UNDP-së)

Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të jenë shumë mosbesues me njëri tjetrin. Në pyetjen se kur kanë të bëjnë me të tjerët, sa mund t'u besohet atyre, vetëm 11.7% të të anketuarëve deklarojnë se shumicës së njerëzve mund t'u besohet. Ky nivel i ulët i besimit ndërpersonal, i cili përsëritet për vite me radhë, është jashtëzakonisht pengues për çfarëdo angazhimi të përbashkët për çështje publike, e sidomos për nisma të shoqërisë civile ku bashkëpunimi dhe veprimi i përbashkët qytetar është elementi thelbësor.



# Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile

Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Suedia  
**Sverige**